

UMBERTO ECO

Jemi ne
luftë me
nazizmin e ri



DAVID BROOKS

Une nuk
jam Charlie
Hebdo



CHRISTIAN CARYL

Armiku
nuk është
aspak feja

Politika

Botim elektronik i ASP në bashkëpunim me Bota.al-Janar 2015

Je suis Charlie

**Të lirë,
në këmbë,
së bashku**



Programi i Shkollës së Studimeve Politike financohet nga Këshilli i Evropës dhe Zyra e Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri si edhe vetë kontributet e pjesëmarrësve



Botim elektronik i Akademisë së Studimeve Politike në bashkëpunim me Bota.al

bota.al

Friday, June 20, 2014

HOME BOTA EKONOMI TEKNOLOGJI HISTORI SHKENCE KULTURE DOSSIER SPORT

INTERVISTA/Habermas: Propozimi im për një Union më demokratik

Jürgen Habermas është sociolog dhe filozof gjerman, i traditës së teorisë kritike dhe pragmatizmit. Ai është bërë i njohur për teoritë e tij të racionalitetit të komunikimit dhe sferës publike. Sipas sondazheve globale, Habermasi pranohet gjerësisht si një prej...

June 19, 2014

BOTIMESHQIP.COM

Në Shqipëri ju i merrni librat brenda 24 orëve dhe i paguani lehtë në dorë kur merrni librat.

Në çdo vend tjetër të botës ju i merrni librat brenda pak ditësh dhe mund të paguani me PayPal, transferë bankare, etj.

botimeshqip.com
Libri Shqip në shqipërisë tuaj

Kontaktet:
Akademia e Studimeve Politike
Adresa:
Qendra Kotoni,
Rr.Donika Kastrioti,
Nr.3,
Kati 4, Zyra 2,
Tirane, Shqipëri
Tel: +355 4 227 2173,
Tel: +355 4 450 4788
E-mail: info@asp.al
Web: www.asp.al
dhe www.bota.al

Përzgjedhja, redaktimi dhe përkthimi i materialeve në këtë buletin kryhet nga alumni i Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike, z. Ermal Gjinaj



PER POLITIKEN:

Për mua, është e domosdoshme të krijoj një imazh fituesi, kështu që, më duhet të mund dikë...

Richard Nixon

Një prej penalteteve për mospërfshirjen në politikë, është se përfundon të qeverisesh nga njerëz që janë inferiorë

Platoni

Vendet më të errët të Ferrit u janë rezervuar atyre që ruajnë neutralitetin në kohë krize

Dante Aligieri

Politika është lufta pa gjakderdhje, ndërsa lufta është politikë me gjakderdhje

Mao Cedun

Politikanët e këqinj dërgohen të qeverisin, prej njerëzve të mirë që nuk votojnë

William E. Simon



Të lirë, në këmbë, së bashku

GILLES VAN KOTE

Drejtor i Le Monde

Emocion, trullosje, por gjithashtu revoltë dhe vendosmëri: nuk gjen fjalë për të shprehur gjerësinë e valës goditëse që po kalon Franca, të nesërmen e sulmit terrorist kundër Charlie Hebdo. Një goditje që na shpie me të gjitha përmasat në atë ndjenjë që përjetoj e gjithë bota më 11 shtator 2001.

Në mes të ditës, në mes të Parisit, gjakftohtë, fanatikët vranë në mënyrë burracake gazetarë, karikaturistë, nënpunës, si dhe policin e ngarkuar për mbrojtjen e tyre. Dymbëdhjetë të vrarë, të ekzekutuar me pushkë automatike, shumica e tyre në vendin e punës në këtë revistë të lirë dhe të pavarur.

Dhe në mes të kasaphanës viktime, viktime të kësaj poshtërsie, kolegë, shokë: Cabu, Charb, Honore, Tignous, Wolinski, si dhe ekonomisti Bernard Maris. Qysh prej vitesh, dekadash, ata rezistonin me karikaturën, humorin dhe paturpësitë e të gjitha fanatizmave, dënonin integralizmat, denonconin gjepurat, denigronin institucionet.

Qysh prej dhjetë vitesh, ata ishin kërcënuar dhe e dinin atë: të marrë të Zotit, islamistë, ndiqnin me urrejtjen e tyre këta “blasfemues”, që guxonin të talleshin me Profetin e tyre. Ekipi i Charlie Hebdo nuk ishte sprapsur, nuk kishte ceduar, nuk mbyllte sytë. Çdo javë, të armatosur vetëm me lapsat e tyre, ata vazhdonin luftën e tyre për lirinë e mendimit dhe të shprehurit.

Disa nuk e fshihnin frikën e tyre, por të gjithë e kapërcenin atë. Ushtarë të lirisë, të lirisë tonë, ata vdiqën për atë. Vdiqën për karikaturat. Nëprmet tyre është liria

e të shprehurit – ajo e shtypit, ashtu si e të gjithë qytetarëve – që ishte shënjestra e vrasësve. Është liria për të informuar dhe për t'u informuar, për të debatuar dhe kritikuar, kuptuar dhe bindur, kjo pavarësi e mendimit, ky guxim i nevojshëm dhe vital i lirisë, që vrasësit kanë dashur ta shtypin me plumbat e tyre.

Kjo lidhje me liritë qëndron në zemër të demokracisë. Por komando xhihadiste na kujton në mënyrë mizore që për disa, sot liria e mendimit dhe e shprehjes është një kërcënim i patolerueshëm kundër ligjit të Zotit, që ata ëndërrojnë të imponojnë. “E gjithë Republika u sulmua”, siç foli kryetari i shtetit François Hollande të mërkurën në mbremje. E sulmuar në sloganin e saj, “Liberté, Egalité, Fraternité, Liri, Barazi, Vëllazëri”, dhe në vlerat që ajo shpreh.

E sfiduar në parimin e saj të laicitetit dhe në angazhimin e saj për të “respektuar të gjitha besimet”, fetare apo filozofike. E sulmuar në vullnetin e saj për të respektuar pluralizmin e bindjeve dhe të ndërgjegjeve – me kusht që ato të respektojnë Republikën.

E sulmuar për ambicjen e saj për të qenë e pandashme. Sepse atentati i kryer kundër Charlie Hebdo nuk është vetëm një krim, ai nuk kërkon vetëm të mbjellë frikën në mendjen e publikut.

Ai është gjithashtu një kurth: dëshiron të endë ndarjet, dyshimet, mosbesimet që kalon shoqëria franceze, dhe sipas shprehjes së ish-ministrit të drejtësisë Robert Badinter, “të hapë një gropë urrejtje midis komuniteteve që përbëjnë Republikën franceze”.

Franca është vënë në shënjestër sepse ajo është në vijën e parë, vetëm apo me aletatet e saj, në luftën e nisur kundër xhihadizmit ndërkombëtar. Është në Mali dhe në Sahel qysh prej dy vitesh, në Irak dhe në kufijtë e Sirisë kundër barbarisë të Shtetit islamik qysh prej disa muajsh. Qysh prej njëzet e katër orësh, mesazhe mbështetëse të panumërta të ardhura nga Evropa, nga Shtetet e Bashkuara dhe më përtej, si dhe nga redaksitë e të gjithë botës, dëshmojnë që komuniteti ndërkombëtar është i ndërgjegjësuar.

Përballë këtyre kërcënimeve, kryetari i shtetit, parardhësi i tij Nicolas Sarkozy dhe të gjithë drejtuesit politikë kanë dënuar me forcë këtë atentat: në këtë provë, Franca duhet të bashkohet në një bllok, të qëndrojë e bashkuar në mbrojtje të vlerave të saj, të parandalojë çdo amalgamë midis autorëve të atentatit dhe bashkësisë së myslimanëve, midis fanatizmit dhe besimit. Drejtuesit kryesorë fetarë, të të gjitha besimeve fetare, kanë mbajtur një diskur të ngjashëm.


Nuk e prisnim më pak këtë nga disa apo të tjerë. Por është imperative që ky konsensus të rezistojë, nesër në përpjekjen për të gjetur në këtë dramë rastin e polemikave të politizuara.

I takon formacioneve politike që të tregohen në lartësinë e kësaj sfide përballë demokracisë. Sepse këto vrasje na vendosin përpara përgjegjësive. Për të mos stigmatizuar myslimanët e Francës, për t'i u përgjigjur këtij sulmi kundër lirisë dhe të jetuarit sëbashku me më shumë guxim dhe inteligjencë.

Reagimi i francezëve dëshmon se ata e kanë kuptuar këtë. Kjo na qetëson dhe na siguron. Me dhjetëra-mijëra u mblodhën në sheshin e Republikës në Paris dhe në qendrat e qyteteve kryesore të vendit, ata u mblodhën në mënyrë spontane për të shprehur emocionin e tyre, solidaritetin, zemërimin, vullnetin e tyre për t'i bërë ballë sëbashku, në këmbë, të lirë.

Të gjithë mbanin një mesazh që i përmbliidhte të gjitha këto ndjenja: “Je suis Charlie” – (Unë jam Charlie).

Po, “ne jemi të gjithë Charlie”. Përveç ndjekjes së policisë për t'i gjetur ata, kjo është përgjigja më e mirë që ne mund t'i drejtojmë autorëve të këtij akti lufte kundër Francës dhe francezëve. Ne ia dedikojmë atë viktimave, miqve tanë.



Umberto Eco: Jemi në luftë. ISIS është nazizmi i ri

“Cfarë duhet të thotë njeriu i shkretë përpara fakteve të tillë?” Së pari, Umberto Eco nxiton të sqarojë se nuk e ka lexuar ende “Nënshtrimin”, romanin e ri të Michel Houellebecq, e si pasojë nuk mund të flasë: “Bota është e mbushur me njerëz që flasin për libra të cilët nuk i kanë lexuar, bashkë me ata që thonë se e njohin Kur’anin, ndërkohë që nuk e kanë lexuar asnjëherë”. Por, në lidhje me kushtet prej ku buroi atentati i Parisit ka ç’të thotë që çke me të. “E sigurtë është se kanë ndryshuar modalitetet e luftës”, thotë Eco. “Po zhvillohet një luftë dhe ne jemi brenda saj deri në fyt, ashtu sikurse kur unë isha i vogël dhe i jetoja ditët e mia nën bombardimet që mund të vinin nga një moment në tjetrin, pa e ditur. Me këtë lloj terrorizmi, situata është ekzaktësisht si ajo që kemi përjetuar gjatë luftës”. Romani i ri i Ecos, Numri Zeri, që pritet të dalë sot, hyn në kategorinë e fantapolitikës edhe pse përqëndrohet në të kaluarën e afërt (sezoni i Duarve të Pastra) dhe jo në një të ardhme të afër, si romani i Houellebecq. Dhe nuk janë gazetarët kurajozë të revistës satirike Charlie Hebdo, por të tjerë lloje gazetarësh, shumë më pak të nderuar.

Edhe buja që ka shkaktuar një libër, si “Nënshtrimi”, sigurisht që nuk është e pa-precedentë: “Në historinë e njerëzimit e kemi parë shumë herë. Edhe dënimi me vdekje i Salman Rushdie, për librin e tij Vargjet Satanikë lidhej me një roman... Dhe nuk ishte risi as atëherë. Njerëzit janë masakruar gjithmonë për një libër: Bibla kundër Kur’anit, Ungjilli kundër Biblës etj. Luftërat e mëdha kanë shpërthyer prej feve monoteiste për një libër. Keni parë ndonjëherë animistë që janë përpjekur të pushtojnë botën me armë? Janë fetë e librit që provokojnë luftëra

për të imponuar idenë që përmbajnë tekstet e tyre. Luftërat pagane ishin të gjitha lokale. Ndoshta pak edhe ato romake... Por kartagjenasit luftuan për arsye tregtare, dhe jo për të imponuar kultin e Astartit”.

Umberto Eco ka shkruajtur romane dhe libra, që nga “Emri i Trëndafilin” deri tek më i fundit “Histori e tokave dhe vendeve legjendarë”, që ka në qendër fantazitë perverse (dhe të dhunshme) të shkaktuara nga disa vepra, letrare apo jo, që ndoshta në krye të herës nuk aspironin të paraqiteshin si të vërteta absolute: “Ka dy mijë vjet – thotë – që marrim seriozisht “Eneidën”: Augusti na ka vendosur mbi themele pretendimesh të rëndësishëm. Ka me qindra tekste që janë shndërruar në fantazma të rrezikshme, mbi të gjitha për shkak të atyre që nuk i kanë lexuar”.

A e ndan Eco analogjinë e përshkruar nga Emmanuel Carrere, autor i romanit “Mbretëria” (ngjarjet zhvillohen në dekadat e fillimit të Kristianizmit), një analogji mes kohës që kalojmë dhe epokës që çoi nga qytetërimi greko-romak, tek ai judeo-kristian? “Më duket e pranueshme, ndodh ajo që fatkeqësisht ka ndodhur gjithmonë, vetëm se tani jemi edhe ne brenda... Tridhjetë vjet më parë kam shkruajtur një artikull, ku thoja se ndodheshim përballë jo më një emigrimi si ai i italianëve në Amerikë apo në Zvicër, por një migrimi, dhe migrimet janë globalë, janë shumë të përhapur në hapësirë dhe zgjasin shumë. Që atëherë shkruaja se deri kur të mbërrinim në një ekuilibër të ri, do të derdhej shumë gjak. Qytetërimi perëndimor, e ka apo jo forcën për të qëndruar, por gjendet përballë një procesi kolosal migrimi, ashtu si i ndodhi Romës shumë shekuj më parë”.

Paradoksi për të cilin flet Houellebecq është që bota myslimane nga pikëvështrimi social është më pranë të djathtës ekstreme, e cila dëshiron ta shtyjë me të gjithë forcat. “Nuk më duket e drejtë që të flitet me përgjithësi duke thënë “myslimanë”, ashtu si nuk do të ishte korrekte të gjykonim Krishtërimin mbi bazën e metodave të përdorura nga Cesare Borgia. Por sigurisht që mund të thuhet për ISIS-in, që është një formë e re nazizmi, me metodat e veta të shfarosjes dhe vullnetin apokaliptik për të marrë kontrollin e botës”.

Perspektiva që qytetërimi perëndimor në krizë, të bëhet aleat me vende arabë, a është thjeshtë një fantapolitikë romanesh? “Shkrirja në një e qytetërimeve është një gjë që mund të ndodhë falë migrimeve. Kur në Itali të ketë 50 milionë jashtëkomunitarë dhe 10 milionë italianë, do të ndodhë ndoshta ajo që ka ndodhur dy mijë vjet më parë. Në fund të fundit ka ndodhur më parë në Azi dhe gjetkë: mongolët në Kinë etj”.

Nuk mund të mohohet që është një version i cili shkakton frikë, kur e mendon sot: “Është e qartë se të gjithë ndryshimet e mëdhenj na terrorizojnë. Shikoni, mua pak vite jetë më mbeten, por kam nipër, dhe uroj që të mësojnë të jetojnë me këto perspektiva. Pastaj, nuk do të ishte aq terrorizuese të imagjinonim një outlet në vend të Duomos, për shembull”.

Ky është një vizion që edhe mund të materializohet: “Sigurisht, dhe ka nga ata që me siguri do të kënaqeshin”./giornale/



“Charlie Hebdo” / Ja përse sulmi goditi Francën mu në zemër

NGA AGNES POIRIER

Shfaqja e disa gazetarëve francezë, në çatinë mbi zyrat e gazetës “Charlie Hebdo”, dukej se ishte alarmi i parë. Ata po u fshiheshin 3 njerëzve të armatosur që sapo kishin hapur zjarr, kundër kolegëve të tyre, gjatë mbledhjes së Këshillit Botues të gazetës së përjavshme satirike.

Që prej atij çasti, ngjarjet rrodhën shumë shpejt. Presidenti francez, Fransua Holond, mbërriti shpejt në vendin e ngjarjes. Natyra terroriste e këtij akti u konfirmua thujse menjëherë dhe numri i viktimave ishte tronditës: 12 të vdekur dhe 11 të plagosur, disa në gjendje kritike për jetën.

Duket se operacioni ishte i përgatitur, në një stil qartazi ushtarak, dhe me përdorimin e armëve tipike luftarake. E çfarë mund të bënin karikaturistët me stilolaps dhe letër, kundër vrasësve të pajisur me armë automatike?

Lajmi u përhap shumë shpejt, duke ngjethur mbarë Francën.

Pastaj u shpallën emrat e të vdekurve dhe ky është ndoshta momenti kur vetë lajmi vdes. Karikaturistët me “emra pendësh”, Sharb, Kabu, Uolinski dhe Tinjus, të njohur nga miliona njerëz në Francë, qenë vvarë, një akt makabër që i ngjan një pike në një varg bosh.

Sidomos Kabu dhe Uolinski, të dy në fund të të 70-ve, kanë bashkëshoqëruar gjenarata të tëra francezësh, duke i bërë ata të qeshin çdo javë, në botime të ndryshme, në radio dhe në televizion, për më shumë se 50 vjet.

Nga humori që ata shkaktonin kam parë me sytë e mi njerëz të paafte për të përfunduar fjalitë e tyre, të detyruar të mbyllnin telefonin për të lexuar lajmin e tepër të lëvizshëm për të folur.

Kam parë blerës, që teksa i shihnin krijimet e artistëve, ndalnin hapin në rrugë, përhumbeshin ulur nëpër stola, apo të tjerë që shkriheshin në lot, kur mësonin lajmet nga telefonata e një shoku.

Sikurse komentoj pas ngjarjes nga Uashingtoni, në frëngjisht dhe anglisht, Sekretari Amerikan i Shtetit, Xhon Kerri: Franca i ka dhënë mjaft demokracisë në botë dhe e di më mirë se cilido çmimin e madh të Lirisë.

Francezët, rikujtuan të tronditur se Liria, Barazia dhe Vëllazëria – vlerat për të cilat ata kanë luftuar shumë, për t'i parë ato çdo ditë në ballinën e shkollave dhe ndërtesa publike – janë të kërcënuara nga terroristët.

Ndërsa identitetet e terroristëve ende nuk janë konfirmuar, Franca, me komunitetin më të madh musliman në botën perëndimore (rreth 6 milionë nga një popullsi prej 66 milionësh), ka qenë përherë një objektiv kryesor i ekstremistëve islamikë.

Në vitin 1995, Parisi u shokua nga një valë sulmesh terroriste nga ana e ekstremistëve algjerianë të GIA-s, që shkaktuan një bilanc të përgjithshëm prej 12 viktimash. Në vitin 1986, organizata Hezbollah, pati kryer një tjetër sulm vdekjeprurës, duke bombarduar magazinat e mëdha “Tati” çka shkaktoi vdekjen e 8 kalimtarëve të pafajshëm.

Shërbimet sekrete franceze njihen për aftësinë e tyre në parandalimin e komplotëve të tilla dhe presidenti Holond zbuloi se shumë sulme të planifikuara ishin arritur të shmangeshin kohët e fundit.

Në javët dhe muajt në vazhdim do të ketë shumë reflektime shpirtërore mes francezëve, dhe presidenti Holond po përballet me pyetje të vështira dhe detyra të mëdha përpara.

Mes së djathtës ekstreme të Marin Lë Pen, që i fryn zjarrit të ndarjes kombëtare, duke fajësuar emigrantët për shumë probleme sociale dhe ekonomike që ka vendi, si dhe një të majte që përpiket jo pak për të mos stigmatizuar qytetarët e saj muslimanë, ka realisht pak hapësirë të lirë, për një debat të fuqishëm por dhe të qetë publik.

Lajmi se shkrimtari francez Mishel Ulebek, ndodhet tani nën mbrojtjen e forcave të policisë, si pasojë e sulmit të djeshëm në “Charlie Hebdo”, nënkupton se Ministria e Brendshme franceze nuk ka shanse reale për të mposhtur terrorizmin. Por kjo tregon gjithashtu, gradën e rënduar të sëmundjes që ka prekur zemrën e shoqërisë franceze.

Ngjarjet, në romanin e fundit të Olebekut, zhvillohen gjatë zgjedhjeve presidenciale të vitit 2022.

Pas një raundi të dytë zgjedhor, mes një kandidati së të djathtës ekstreme dhe një islamiku francez, ky i fundit arrin të fitojë me ndihmën e së majtës liberale, dhe kështu republika franceze rithemelohet si një Shtet Islamik. Sot, një imam francez i quajti gazetarët e vdekur dhe karikaturistët e “Charlie Hebdo” “dëshmorë të lirisë”. Por Franca ndërkaq, mund të ketë zbuluar edhe çmimin e vetëkënaqësisë së saj, duke mësuar se një vëllazërim i tillë, nuk duhet të merret kurrë si i mirëqenë. /cnn/



E lirë dhe rebele, redaksia që nuk ekziston më

Të zënë në befasi, gjatë mbledhjes së mëngjesit. Ish-drejtori Val: Kishte gjak kudo. Betejat kulturore të zhvilluara me anë të humorit. Ata vranë një mënyrë të menduari

Kati i poshtëm i redaksisë së gazetës, gjendet tek nr.10 në rrugën “Nicolas-Appert”, një aks i ngushtë dhe i shkurtër në distriktin e XI të Parisit, vetëm pak hapa larg nga Bastija. Prej vitit 2012, ishte selia veçanërsht anonime dhe e veçuar e “Charlie Hebdo”, e vetëpërcaktuar si një “gazetë e papërgjegjshme”, një etikim ky që ndershmërisht, ishte shënuar me të kuqe dhe të bardhë poshtë logos së gazetës.

Ndoshta e papërgjegjshme, por sigurisht jo e pandërgjegjshme për rreziqet ndaj të cilave ishte ekspozuar vitet e fundit, me kryqezatën kokëfortë laike, kundër të gjitha fanatizmave fetare. “Sapo është shfarosur, një mënyrë e të menduarit” – u shpreh mes lotëve, ish-drejtori i gazetës, Filip Val. Por mbi të gjitha një mënyrë për të mbrojtur, përmes së qeshurës, lirinë e mendimit. E megjithatë asgjë dhe askush, dukej se qe në gjendje të ndalte dallgën e përjavshme, të një sarkazme të egër, disa herë paksa vulgare, por pa dyshim të pavarur: “Një thertore e vertetë” – pohoi Val, vetëm pak çaste, pasi shkoi në vendin e masakrës, që vrau kolegët e tij.

“Isha atje. Ka gjak kudo, ata nuk kishin asnjë mundësi të largoheshin. Nuk i kanë bërë kurkujt asgjë të keqe, ishin thjesht mbrojtës të lirisë. Tashmë nuk mund të flasin më kurrë”. Dje, heshtja, habia dhe tronditja e madhe psikologjike, përfshiu shtëpinë e fundit të “Charlie Hebdo”.

E përjavshmeja, që në vitin 2002, kishte dalë në mbështetje të gazetares italiane Oriana Falaçi, me rastin e publikimit në Francë të librit të saj “Zemërim dhe krenari”, kishte marrë prej kohësh akuza se ishte islamofobe, por edhe antisemite. Kjo e fundit ndodhi në vitin 2008. Revista, që në atë kohë drejtohej nga Val, ishte ndarë me dhimbje ngë njëri prej bashkëpunëtorëve të saj më të njohur, karikaturisti Moris Sine, i njohur më mirë me pseudonimin “Sine”. Ky i fundit u akuzua për antisemitizëm nga “Nouvel Observateur” (Vëzhguesi i ri), për shkak të një dëshire të zjarrtë për konvertimin e Zhan Sarkozisë, djalit të presidentit të atëhershëm të vendit që kishte për qëllim të martohej me një grua me origjinë hebreje.

Bota gazetareske ishte ndarë në pro dhe kundra Sinesë, sot 86-vjeç. Si pasojë e debateve të shumta, Sine i dha fund bashkëpunimit me gazetën. Në vitin 2009, Charlie (emër i zgjedhur në nder të revistës satirike amerikane “Charlie Brown”, sikurse edhe është psh. “Linus” në Itali), pas 17 vjetësh, ndërroi drejtues.

Në krye mbërriti 40-vjeçari Stefan Sharbonie, që gjithashtu njihet më tepër me nofkën ‘Charb’. Agresiv dhe i vendosur, pas vetëm 2 vitesh përfundoi i shoqëruar me eskortë, pas publikimit të disa karikaturave të debatueshme mbi profetin Muhamed. Truproja e tij humbi jetën së bashku me të, një ditë më parë, ndërsa trupat e caktuara për karikaturistët e tjerë të njohur, u ishin hequr kohët e fundit. “Charlie Hebdo”, nuk dukej se ishte më në shenjestrën kryesore të fanatikëve fetarë.

Nuk ishte asnjë makinë policie që ruante godinën. Në pallatet ngjitur, jo të gjithë e dinin se ishin bërë fqinjë me gazetën e famshme satirike franceze. Redaksia ishte zhvendosur atje, vetëm pak kohë pas atentatit në nëntor të vitit 2011, kur ambjentet e dikurshme të saj u dogjën dhe shkatërruan.

Vetëm një tabelë e vogël në hyrje të godinës tregon vendndodhjen e redaksisë. Asnjë gjurmë tjetër.

Pas dritareve, në dhomat ku policia shkencore përpiket që të orientohet brenda asaj “thertoreje”, shfaqen tavolinat e punës, libraria, mobilimi i gazetës së themeluar në vitin 1970 nga shkrimtari satirist italo-francez, Fransua Kavana. I njohur mbi të gjitha “për riprerjet e tij”, duke rimarrë në këtë mënyrë, një përcaktim të bujshëm për emigrantët italianë në Francë, Kavana ndërroi jetë një vit më parë në 29 janar.

Mbledhja e redaksisë së të përjavshmes kishte filluar në një atmosferë të qetë, aty rreth orës 10.00 të paradites së djeshme, në katin e tretë të ndërtesës. Mbi tavolinë ndodheshin disa kopje të numrit më të fundit, që sapo ishte dërguar në treg (dhe që dje ishte thujse e pamundur që blihej një kopje), nr. 1177, me kopertinë e ndezur të regjizorit dhe poetit kontroversal, Mishel Ulebek, veshur si magjistar, shënjestra e fundit e ironisë së karikaturistit Renald Luzie, i njohur shkurtimisht si “Luz”.

“Në vitin 2015, do të humbas dhëmbët. Ndërsa në vitin 2022, do të mbaj Ramazan”- janë fjalët që Luz vë në gojën e autorit të librit “Nënshtrimi”. Romani, që flet për të ardhmen islamike të republikës franceze, është publikuar edhe në Itali. Deri në orën 11.30 të paradites, e djeshmeja ishte një e mërkurë e zakonshme për Sharb-in, Stefan Sharbonie, 47 vjeç, drejtor i gazetës prej më shumë se 5 vitesh dhe për stafin e tij të karikaturistëve dhe komentatorëve, të mbledhur për të diskutuar për numrin e ardhshëm. E mërkura, është zakonisht dita kur redaksia është më e populluar se zakonisht. Ditët e tjera – thotë një redaktore, ambjentët janë thujse të boshatisura.

Dje në redaksi ndodheshin shumë prej figurave më të njohura: 80-vjeçari Zhorzh

Uolinski, Zhan Kabu, Bernar Verlak që firmoste karikaturat e tij me nofkën “Tignous”, si dhe një prej shtyllave kryesore të “Charlie Hebdo”, ekonomisti i njohur Bernar Mari, njëherazi bashkëpronar i gazetës.

Editoriali i tij i fundit, në faqen 3 të gazetës titullohej në mënyrë provokuese “Dominimi”, sigurisht duke iu referuar librit të Ulebekut, që i kishte dedikuar një tjetër shkrim kritik, në një rubrikë në brendësi të gazetës.

“Kur thuhet se duhet feja, për të mos kryer akte të këqija – shkruante ai – mendohet në të vërtetë se duhet policia, cka nuk është e njëjta gjë. Provoni të zhdukni policinë në një ditë, dhe do të shihni se frika ndaj Zotit, nuk do të pengojë njerëzit të ndërmarrin akte të dhunshme”. Në një pusullë, që mund të pritët dhe ngjitet diku, ai ftonë lexuesit: “Shpëtoni Charlien”.

Një tekst prekës, i lexuar sot: “Të dashur lexuese dhe lexues, i gjithë ekipi ju thotë faleminderit. Falë jush, “Charlie Hebdo”, do t’ia hedhë edhe këtij dimri! Gati 200 mijë që na dhuruan në pak muaj, na japin pak frymëmarrje... Kemi ende shumë projekte për të realizuar, si dhe për të pëmirësuar edhe më shumë gazetën, që është e juaja. Vazhdoni të na mbështesni me çdo mënyrë. Lufta vazhdon...”. Për të konfirmuar këtë mbështetje, dje mbi 35 mijë qytetarë, vërshuan rrugëve të Parisit, ndërsa 100 mijë të tjerë në gjithë Francën. /messaggero/



Unë nuk jam Charlie Hebdo

DAVID BROOKS

Në shumicën e shoqërive, ekziston tryeza e të rriturve dhe tryeza e fëmijëve. Njerëzit që lexojnë Le Monde apo organe të tjerë janë në tryezën e të rriturve. Shakaxhinjtë dhe njerëzit si Ann Coulter apo Bill Maher janë në tryezën e fëmijëve. Atyre nuk u ofrohet respekt i plotë, por ata dëgjojnë sepse, në mënyrën e tyre, thonë gjëra të domosdoshme që askush tjetër nuk i thotë

Gazetarët e Charlie Hebdo janë duke u përshëndetur me të drejtë si martirë në emër të lirisë së shprehjes, por le ta themi: Nëse ata do të ishin përpjekur ta botonin gazetën e tyre satirike në cilindo universitet amerikan gjatë dy dekadave të fundit, nuk do të kishte zgjatur as 30 sekonda. Studentët dhe grupet e fakultetit do i kishin akuzuar për “hate speech” – fjalë urrejtjeje. Administrata do u kish ndërprerë fondet dhe do i kishte mbyllur.

Reagimi publik ndaj sulmeve në Paris ka zbuluar se ka shumë njerëz që nxitojnë të shfaqin interes për ata që fyejnë pikëpamjet e terroristëve islamikë në Francë,

por që janë shumë më pak tolerantë ndaj atyre që fyejnë pikëpamjet e tyre në vendin e tyre.

Vetëm shihni njerëzit që kanë reaguar në mënyrë të tepruar ndaj “mikro-sulmeve” në kampuset universitarë. Universiteti i Illinoisit pushoi nga puna një profesor që në leksionet e tij fliste për pikëpamjet që katolikët romanë kanë për homoseksualizmin. Universiteti i Kansasit pezulloi një profesor për arsye se kishte bërë një koment të ashpër kundër N.R.A. Vanderbilt University, pasi ky mohoi një grup kristian i cili kishte këmbëngulur që universiteti të udhëhiqej nga të krishterë.

Amerikanët mund ta lavdërojnë Charlie Hebdonë se ka qenë guximtar në botimin e karikaturave që vënë në lojë Profetin Muhamed, por nëse Ayaan Hirsi Ali e ftojnë në kampus, shpesh herë ka thirrje për t’i mohuar asaj podiumin.

Kështu që, ky mund të jetë një moment që mëson shumë. Ndërkohë që jemi të tmerruar prej vrasjes së atyre gazetarëve dhe botuesve në Paris, ndoshta është koha që të kemi një qasje më pak hipokrite ndaj figurave tona kontroverse, provokatorë dhe satiristë.

Gjëja e parë që duhet thënë, është se çfarëdo që të keni shkruajtur në faqen tuaj të Facebookut dje, është e pasaktë për shumicën prej nesh që të themi “Unë jam Charlie Hebdo”. Shumica prej nesh zakonisht nuk bëjmë këtë lloj humori qëllimisht fyes, në të cilin është e specializuar ajo revistë.

Mund ta kemi nisur në atë mënyrë. Kur je 13 vjeç, të duket e guximshme dhe provokuese që t’ia fusësh gishtin në sy autoritetit, apo të vësh në lojë besimet fetarë të njerëzve të tjerë.

Por pas pak kohësh, kjo gjë duket fëmijërore. Shumica prej nesh shkojmë drejt pikëvështrimeve më të komplikuar të realitetit, me këndvështrime më mirëkuptues ndaj të tjerëve. (Vënia në lojë bëhet më pak argëtuese teksa bëhesh i vetëdijshëm se sa shpesh vihesh edhe vetë në lojë). Shumica prej nesh përpiqemi që të tregojmë një minimum respekti për njerëzit me besime dhe fe të ndryshme. Përpiqemi të hapim bashkëbisedime ku dëgjojmë, në vend që të fyejmë.

Megjithatë, në të njëjtën kohë e dijmë që provokatorët dhe figura të tjera të pazakonta kanë role publike të dobishëm. Satiristët dhe humoristët ekspozojnë dobësinë dhe vanitetin tonë, atëherë kur ndihemi krenarë. Ata shpotisin vetëfryrjen e njerëzve të suksesshëm. Ata sheshojnë pabarazinë sociale duke ulur poshtë të gjithëpushtetshmit. Kur janë efikasë, na ndihmojnë që të përballemi në mënyrë të përbashkët me dobësitë tona të karakterit, duke qenë se e qeshura është një prej eksperiencave finale të lidhjes mes njerëzve.

Veç kësaj, provokatorët dhe humoristët ekspozojnë budallallëkun e fundamentalistëve. Fundamentalistët janë njerëz që marrin gjithçka “fjalë për fjalë”. Ata nuk janë të aftë për të patur disa këndvështrime. Ata janë të paafte të shohin që, ndërkohë që feja e tyre mund të jetë e denjë për nderimin më të thellë, është gjithashtu e vërtetë që shumica e feve janë disi të çuditshme. Satiristët ekspozojnë ata që nuk janë të aftë të qeshin me vetveten dhe na mësojnë ne të tjerëve që ndoshta duhet ta bëjmë këtë.

Shkurt, kur mendojmë për provokatorë dhe ofendues, ne duam të ruajmë standartet e qytetërimit dhe respektit, e në të njëjtën kohë të lëmë hapësirë për njerëzit krijues dhe sfidues që janë të lirë prej manierave dhe shijeve.

Nëse përpiqesh që ta heqësh këtë ekuilibër të brishtë me ligje, kode të fjalës dhe ndalim të folësve, do të përfundosh me një censurë të egër dhe një bashkëbisedim të mbytur. Është pothuajse gjithmonë e gabuar që të përpiqesh të shtypësh fjalën, të krijosh kode për shprehjen dhe të mos ftosh njerëz të flasin publikisht.

Fatmirësisht, manierat sociale janë më të lakueshme dhe të zhdërvjellëta se sa ligjet dhe kodet. Shumica e shoqërive kanë ruajtur me sukses standarte të qytetërimit dhe respektit, ndërkohë që kanë lënë të hapura rrugët për ata që janë argëtues, jocivilë dhe ofendues.

Në shumicën e shoqërive, ekziston tryeza e të rriturve dhe tryeza e fëmijëve. Njerëzit që lexojnë Le Monde apo organe të tjerë janë në tryezën e të rriturve. Shakaxhinjtë dhe njerëzit si Ann Coulter apo Bill Maher janë në tryezën e fëmijëve. Atyre nuk u ofrohet respekt i plotë, por ata dëgjohen sepse, në mënyrën e tyre, thonë gjëra të domosdoshme që askush tjetër nuk i thotë. Me fjalë të tjera, shoqëritë e shëndetshme nuk e mbysin fjalën e lirë, por ato u ofrojnë “tryeza” të ndryshme llojeve të ndryshëm të njerëzve. Studiuesit e mençur dëgjohen me respekt. Satiristët dëgjohen me gjysmë-respekt. Racistët dhe antisemitët dëgjohen përmes një filtri turpi dhe mosrespekti. Njerëzit që duan të dëgjohen me vëmendje duhet që ta fitojnë këtë përmes sjelljes së tyre. Masakra në Charlie Hebdo duhet të jetë një rast për t’u dhënë fund kodeve të shprehjes. Dhe duhet të na kujtojë që të jemi ligjërisht tolerantë ndaj zërave ofendues, ndonëse jemi diskriminues nga pikëpamja sociale./NYT/
e.gj./www.bota.al



Dhurata e Volterit, rrënjët e betejës për fjalën e lirë

Në prag të sulmit vdekjeprurës në zyrat e revistës “Charlie Hebdo”, historiani Tom Holland, ishte një nga ata që komentoji në “Twitter” karikaturën e Profetit Muhamed. Në këtë shkrim, ai shpjegon pasojat e luftës për të mbrojtur fjalën e lirë

Fetë nuk ekzistojnë vetëm për të patur martirë. Në 1 korrik 1766, në Abbeville, në veri të Francës, një fisnik i ri i quajtur Lefebvre de la Barre u shpall fajtor për blasfemi. Akuzat kundër tij ishin të shumta, se ai kishte kryer nevojat personale mbi një kryq, kishte pështyrë ndaj disa pikturave fetare dhe se nuk kishte pranuar të hiqte kapelen nga koka, gjatë një meshe në Kishë.

Këto krime, së bashku me përdhosjen e një kryqi prej druri mbi urën kryesore të Abbeville, ishin të mjaftueshme për ta dënuar La Barre-n me vdekje. Pasi iu pre gjuha dhe koka iu copëtua, eshtrat mortore iu dogjën nga xhelati dhe iu hodhën në lumin Somë.

Me hirin e viktimës u përzje edhe hiri i një libri, që ishte gjetur në studion e La Barre dhe që ishte hedhur në zjarr së bashku me kufomën e tij, “Fjalori filozofik”, i filozofit asokohe famëkeq, Volterit. Vetë ky i fundit, pasi mësoi mbi fatin e lexuesit të tij mbeti i shtangur. “Supersticioni” – deklaroi ai nga streha e tij në

Zvicër “po i vë flakën gjithë botës!”.

Mjerisht, edhe pas më shumë se dy shekujsh e gjysmë, gjallon ende ideja që dikush mund të dënohet me vdekje për kritikën ndaj një dogmë fetare, që mund të prekë një shumicë njerëzish në Perëndim. Vlerat e fjalës së lirë dhe tolerancës, të cilat Volteri i propagandoi gjatë gjithë jetës së tij, u sanksionuan si mishërim i asaj që evropianët e cilësojnë si ligji me çmimin më të madh në qytetërimin e tyre.

Volteri, me buzëqeshjen e tij ironike, shërben ende si një shenjt mbrojtës i tyre. Në Francë, ku idealet shekullariste janë veçanërisht të çmuara, e drejta e lirisë së fjalës evokohet rregullisht nga ata që e ndjejnë se trashëgimia e Iluminizmit është seriozisht e kërcënuar.

Kur Philippe Val kryeredaktori i “Charlie Hebdo”, botoi në vitin 2008 një libër, duke mbrojtur të drejtën e karikaturistëve për të qesëndisur dogmat fetare, titulli ishte mjaft domethënës: “Reviens, Voltaire, ils Sont Devenus Fous” (Kthehu Volter, ata kanë luajtur mendsh!). Gjithësesi, nuk ishin të krishterët, ata të cilët Val i etiketonte ekskluzivisht si të çmendur. Ndërmjet shekullit të XVII dhe XXI, peisazhi fetar në Francë ka ndryshuar rrënjësisht. Jo vetëm fuqia e Kishës Katolike është rudhur ndjeshëm, por në vend kanë mbërritur rreth 6 milionë emigrantë, që i përkasin një besimi krejt të ndryshëm.

Islami, ndryshe nga katolicizmi, ka trashëguar nga hebrejtë refuzimin e prerë të artit figurativ. Ky besim fetar e nderon Muhamedin – profetin, që nga pasuesit e tij besohet se ka marrë zbuluesen përfundimtare të Zotit, Kuranin – si modeli më ideal të sjelljes njerëzore.

Fyerjet ndaj tij janë cilësuar tradicionalisht nga juristët myslimanë si të barabarta me mosbesimin dhe ky i fundit përbën një krim që meriton shkuarjen në Ferr. Gjithësesi, në Kuran, nuk ka asnjë citat që në mënyrë të qartë e cilëson një gjest të tillë, fajin më të rëndë të mundshëm.

“E vërteta rrjedh prej Zotit juaj, kështu që kushdo dëshiron, le të besojë, e kush të dojë, le ta mohojë”. Megjithatë, një histori e shkuar në biografinë më të vjetër mbi jetën e Muhamedit, lë të kuptohet ekzistencën e masave ndëshkuese. Aq ndëshkuese, sa disa dijetarë myslimanë – që përgjithësisht ngurrojnë të pranojnë mundësinë që biografia më e hershme e profetit të tyre mund të jetë e pabesueshme – kanë shkuar aq larg sa për të vënë në dyshim vërtetësinë e saj.

Historia bën fjalë për fatin e Asma bint Marwanit, një poeteshë nga vendlindja e Profetit, Meka. Pasi ajo ishte tallur me Muhamedin në vargjet e saj, ky i fundit bërtiti: “Kush do të më shpëtojë nga vajza e Marwanit?” Dhe pa dyshim, atë natë ajo u vra nga një prej ndjekësve të tij, teksa ishte duke fjetur gjumë.

Sikurse dëshmohet, vrasësi u falënderua personalisht nga Profeti. “Ju ndihmuat si Zotin, ashtu edhe të dërguarin e tij!”.

“Ecrasez të infame,” (Shtypni atë çka është e turpshme) – këshillonte Volteri lexuesit e tij. Islami, gjithashtu, bën të njëjtën kërkesë. Dallimi natyrisht qëndron tek termi “turp”, që mbetet për t’u përcaktuar.

Karikaturistët e “Charlie Hebdo”, në vitin 2011 botuan në kopertinën kryesore imazhin e një Muhamedi me sy të çakërdisur, ashtu si më parë kishin portretizuar një Jezu Krisht, si pjesëmarrës në një garë duke thënë: “Unë jam një vip, më nxirri nga këtu!” Apo Papa Benediktin XVI, që shfaqej duke mbajtur gjatë një meshe në duart një prezervativ. Këto ishin edhe fenomenet e preferuara të gazetës që gjendeshin sa në politikë po aq sa edhe në fe.

Por për personat e armatosur, që disa ditë më parë ndërmorën sulmin fatal në zyrat e “Charlie Hebdo”, vizatime të tilla përbëjnë një tallje për profetin – të cilin ata ndjejnë se duhet të ekzistojë përtej çdo lloj kritike, sado e vogël qoftë ajo. Midis këtyre dy pozicioneve, kur ata përndiqen me pasion të barabartë nga të dyja anët, ndoshta nuk mund të ketë ndonjë strehim të mundshëm për ta.

Pa dyshim, çështja e shkrimtarit iranian Salman Rushdie, shërbeu si simptomë fillestare e gjithë këtij debati. Që prej atëhere, si një dhimbje e shurdhët dhëmbi që kurohet periodikisht me barna, problemi kurrë nuk është zhdukur.

Unë personalisht kam patur një përvojë personale të ngjashme, në vitin 2012, me një film që realizova për televizionin "Channel 4". "Islami: Një histori e patre-guar" hidhte dritë mbi konsensusin e shumë historianëve, se shumë prej asaj që muslimanët kanë besuar tradicionalisht për jetën e Muhamedit, nuk ka gjasa të jenë bazuara mbi faktet historike.

Kjo provokoi një stuhi reagimesh të ashpra, përfshi këtu edhe kërcënime me vdekje. Ndryshe nga "Charlie Hebdo", unë nuk kisha ndërmend që të ofendoja kërkënd. Unë nuk jam shkrimtar satirik, dhe zakonisht nuk më gëzon lëndimi i ndjenjave të njerëzve të tjerë.

Megjithatë, edhe unë ndjej se disa të drejta themelore ia vlen që të mbrohen, mes tyre liria e historianëve për të vënë në dyshim mitet e origjinës së feve. Kjo ishte arsyeja së përse, kur dëgjova lajmin e sulmit në Paris zgjedha të bëj diçka që në rrethana të tjera nuk do e kisha bërë kurrë, të postoja një koment mbi karikaturën e Muhamedit në "Charlie Hebdo".

Ndërkaq BBC, vendosi të mos e riprodhojë karikaturën për këtë artikull. Shumë media të tjera, ndonëse jo të gjitha, kanë bërë të njëjtën gjë. Unë refuzoj të jem duarlidhur, për shkak të blasfemisë faktike të thyerjes së tabuve fetare.

Ndërsa, në rrethana normale, jam krejtësisht i lumtur të mos tallem me besimet fetare, që njerëzit e tjerë i konsiderojnë të shtrenjta, ky moment është larg të qënit normal. Sikurse kam theksuar në postimin tim në "Twitter", e drejta për të vizatuar Muhamedin pa u qëlluar me armë, është po mjaft aq e çmuar për shumë nga ne në Perëndim, sikurse mesa duket është edhe për vrasësit e gazetarëve të "Charlie Hebdo".

Ne kemi gjithashtu vlerat tona, dhe nëse nuk jemi të gatshëm të ngrihemi në këmbë për to, atëherë ato rrezikojnë të na humbin nga sytë. Kur është fjala për përcaktimin e asaj që është e turpshme, unë për vete nuk kam asnjë dyshim se në cilën anë të llogores jam./bbc/



Armiku nuk është feja

CHRISTIAN CARYL

Kishte kuptim që njëri prej të parëve që folën pas masakrës në revistën Charlie Hebdo të ishte Salman Rushdie, njeriu që kaloi vite të jetës duke sfiduar një kërcënim me vdekje, pasojë e një akuze për blasfemi. Ndonëse Rushdie nuk është një prej shkrimtarëve të mi të preferuar, e kam admiruar gjithmonë qëndrimin e tij të palëkundur në mbrojtje të lirisë së fjalës – dhe jam i kënaqur që qeveria britanike i mbrojti të drejtat e tij.

Po kështu, nuk dua të vë aspak në diskutim të drejtën e tij për të bërë deklaratën që bëri dje – ndonëse jam tërësisht kundër saj. Ja se çfarë tha ai:

Feja, një formë mesjetare e mosarsyes, kur kombinohet me armët moderne shndërrohet në rrezik për liritë tona. Ky totalitarizëm fetar ka shkaktuar një mutacion vdekjeprurës në zemër të Islamit, dhe pasojat tragjike i shohim në Paris sot. Unë jam me Charlie Hebdo, ashtu si të gjithë duhet të jemi, për të mbrojtur artin e satirës, i cili ka qenë gjithmonë një forcë për lirinë kundër tiranisë, pandershmërisë dhe marrëzisë. “Respekti për fenë” është bërë një frazë e koduar që do të thotë

“frikë nga feja”. Fetë, ashtu si të gjithë idetë e tjera, meritojnë kritikë, satirë dhe, po, mosrespektin tonë, pa u trembur.

Nuk kam aspak problem me fjalinë e fundit. Nuk e kuptoj se si mund të kesh një shoqëri të lirë, nëse nuk lejon mundësinë e mosrespektit. Nëse kushdo prej nesh mundet të mbyllë një bisedë duke pretenduar se jemi “të fyer” nga diçka që ka thënë dikush tjetër, atëherë nuk do të kemi fare bashkëbisedime. Kështu që, jam dakord me këtë fjali.

Ato që më shqetësojnë janë fjalët e para të deklaratës së Rushdies. “Feja”. Të gjithë fetë. Jo një besim i caktuar (gjë që edhe kjo në vetvete do të kish qenë një përgjithësim i madh), por praktikisht, të gjithë ata që besojnë. Ma do mendja që ky pretendim me shtrirje kaq të gjerë bëhet i kualifikueshëm prej shprehjes “kur kombinohet me armët moderne”, por gjithësesi unë e kam të vështirë ta pranoj. Frazja “një formë mesjetare mosarsyeje” tregon se është vetë ideja e besimit fetar që përbën thelbin e problemit për Rushdie. Nëse je i bindur që të gjithë besimet janë një formë mosarsyeje, atëherë me siguri që nuk mund të presësh të kesh një bashkëbisedim racional me to.

Është e mundur që Rushdie të ketë thënë “feja”, si një sinonim diplomatik për “Islamin”. Në fund të fundit, atentatorët, që thanë se i përkisnin al Kaedës, është e qartë që vunë në shënjestër Charlie Hebdo për shkak të karikaturave të revistës për Islamin. Megjithatë, tingëllon e tepruar që për këtë sulm të fajësosh anëtarët e një komuniteti fetar 1.7 miliardësh. Shumë myslimanë përreth botës e kanë denoncuar me shpejtësi vrasjen. Lidhja Arabe dhe një sërë qeverish me shumicë myslimane e kanë dënuar. Universiteti Al Azhar, instituti më i lartë arsimor i myslimanëve sunitë e ka quajtur sulmin “një akt kriminal”.

Kjo nuk do të thotë se nuk ka shumë probleme në pjesë të ndryshme të botës islamike sot. Intoleranca ndaj pikëpamjeve kundërshtuese – gjë që manifestohet në ligjet për blasfeminë, për shembull – është një problem i madh. (Provoni të ndërtoni një sinagogë në Riad). Por është shumë e kollajtë të fajësosh për gjithë këto një “Islam” monolit. Sapo kam lexuar një koment të një konservatori amerikan që argumenton se “mungesa e tolerancës ndaj lirisë së shprehjes i ka rrënjët në Islamin klasik” – ndonëse, ma do mendja, definicioni i tij i “klasikes” nuk përfshin periudhat kur bota islamike mburrej me më shumë tharm kulturor dhe mendim të lirë se sa pjesët e krishtera të botës.

Mund të tingëllojë tronditëse, por në jetën time kam takuar shumë myslimanë, dhe askush prej tyre nuk ka shfaqur ndonjë interes për të më vrarë për shkak të besimit tim. Me sa duket ata thjeshtë nuk e kanë kuptuar “Islamin klasik”.

Atëherë, çfarë mund të them për pretendimin tjetër të Rushdie – se feja është në vetvete një lloj sëmundje mendore që mund të shndërrohet në një “rrezik real për liritë tona”, në çdo moment? Kjo është një pikëpamje që po fiton gjithnjë e më shumë mbështetje mes ndjekësve të mendimtarëve ateistë si Richard Daëkins dhe Sam Harris, të cilët vetëlëvdohen për ndershmërinë dhe gatishmërinë heorike për të hedhur tutje patericat e besimit joracional.

Problemi me këta argumenta është se radhët e besimtarëve përfshijnë njerëz të cilët kanë bërë gjëra të mëdha për të mirën e njerëzimit. Fushata jo e dhunshme e Martin Luther Kingut për drejtësi ishte e paimagjinueshme, pa të kaluarën e tij si një predikues baptist. Pastori luteran, Dietrich Bonhoeffer u ekzekutua nga nazistët sepse denoncoi Holokaustin dhe qortoi kriminalitetin e regjimit të Hitlerit. Budistë si Aung San Suu Kyi dhe Dalai Lama ia kanë kushtuar jetën e tyre mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Murgu augustinian Gregor Mendel besonte se po bënte punën e Zotit kur hidhte themelet e gjenetikës moderne.

Fitues të Cmimit Nobel kohët e fundit, si iraniana Shirin Ebadi dhe jemenesja Tavakkol Karman na kujtojnë se myslimanët besimtarë mund të jenë edhe aktivistë shoqërorë të përsosur. Jo shumë kohë më parë, pashtunët thellësisht besimtarë të Pakistanit të sotëm “prodhuan” Abdul Ghaffar Khanin, një antikolonialist paci-

fist dhe mysliman, pikëpamjet e të cilit ishin të krahasueshme me ato të Gandhit. Po kështu, të jesh ateist nuk është garanci për sjelljen e mirë. Krimet e xhihadit janë të urryer, por edhe al Kaedës dhe Shtetit Islamik u duhet edhe shumë rrugë për të bërë, përpara se të mbërrijnë shifrat e të vdekurve që shkaktuan ateistët e shekullit 20 si Mao, Stalini dhe Pol Poti, të cilët të gjithë së bashku i shkaktuan dhjetëra milionë të vdekur kësaj bote. (Hitleri ëndërronte ditën kur do të mund të varte Papën në Sheshin e Shën Pjetrit). Regjimi më jotolerant në botë sot është me siguri Korea e Veriut, ku edhe një qytetar që shfaq qoftë edhe një minimum besimi në çdo gjë tjetër veç Kim-ëve, mund të presë dënimin me vdekje apo dërgimin në një kamp përqëndrimi.

Problemi i vërtetë nuk është feja. Është një dështim më i thellë psikologjik që prek qeniet njerëzore të të gjithë llojeve, qofshin këta besimtarë ose jo. Quhet “fanatizëm” – ajo cilësi e frikshme që mund të shtyjë edhe mënteligjentët e më të arsimuarit që të besojnë se pimëpamjet që kanë, justifikojnë çdo formë egërsie. Po, shumë prej këtyre njerëzve shtyhen drejt formave absolutiste të fesë – por historia tregon se ata janë njësoj të tërhequr edhe prej formave laike të ekstremizmit politik. Kam dyshime që kjo është diçka që mundemi ta çrrënjosim ndonjëherë prej përvojës njerëzore; mendoj që lufta kundër saj do të vazhdojë sa kohë që njerëzimi do të ekzistojë.

Por kjo nuk do të thotë se duhet të heqim dorë. Dhe këtë javë, kjo do të thotë që të ngrihemi dhe mbështesim vlerat që vrasësit në Rue Nicolas-Appert donin të shkatërronin. Fajësimi i fesë nuk është vendi më i mirë për t’ia filluar. /foreign policy/

Christian Caryl është autor i “Rebelë të çuditshëm: 1979-a dhe lindja e shekullit 21”



Një rend i ri i Luftës së Ftohtë?

NGA MIKHAIL GORBACHEV

Është e qartë që strukturat politike evropiane dhe ndërkombëtare, të cilat kanë qenë dominuese që prej vitit 1989, nuk i kanë rezistuar kohës. Prej fundit të Luftës së Ftohtë, me gjakderdhjen në Evropë dhe Lindjen e Mesme, bota nuk ka dëshmuar më parë një mjedis kaq të tensionuar dhe të brishtë, dhe e gjitha kjo për shkak të një ftohjeje të re mes fuqive të mëdha.

Mesa duket, bota është në prag të Luftës së Dytë të Ftohtë.

Ka disa madje që pretendojnë, se ajo tashmë ka filluar. Ndërkohë, organizmi kryesor ndërkombëtar, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, zor se është duke luajtur një rol ose po ndërmerr veprime konkrete, për të ndaluar vrasjet dhe shkatërrimet.

Përse KS, nuk ka vepruar me vendosmëri, për të vlerësuar si duhet situatën dhe për të hartuar një program të veprimit të përbashkët? Besoj se arsyeja kryesore, është se besimi i krijuar nga puna e madhe dhe përpjekja e përbashkët në përfundimin e Luftës së Ftohtë, ka humbur.

Pa një besim të tillë, marrëdhëniet paqësore ndërkombëtare në botën e sotme të globalizuar, janë të pakonceptueshme. Por të jemi të qartë. Ky besim nuk është se e dëmtua dje. Kjo ka ndodhur shumë kohë më parë. Rrënjët e krizës aktuale, shtrihen në ngjarjet e viteve '90.

Fundi i Luftës së Ftohtë, mendohej se duhet të shenjonte fillimin e një rruge,

drejt një Europe të re dhe një rendi më të sigurtë botëror. Por, në vend të ndërtimit të institucioneve të reja të sigurisë evropiane dhe realizimit të ç'armatimit të Evropës, sikurse dhe u premtua në fakt në Deklaratën e NATO-s në samitin e Londrës në vitin 1990, Perëndimi dhe veçanërisht Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nxituan të shpallin fitoren.

Euforia dhe triumfalizmi “dehën” mendjet e liderëve perëndimorë. Duke përfiturar nga dobësitë e Ruisë si dhe mungesa e një kundërpeshe në arenën botërore, perëndimorët nuk pranuan që të marrin parasysh paralajmërimet kundër pretendimeve, për të patur monopolin e udhëheqjes botërore.

Ngjarjet e muajve të fundit janë pasojat e drejtpërdrejta të vizionit dritëshkurtër, të imponimit të vullnetit të dikujt, duke injoruar interesat e njërit prej partnerëve. Një listë e shkurtër e sjelljeve të përsëritura të vendosjes “para fakt të kryer”, mund të përfshijë zgjerimin e NATO-s në Evropën Lindore, luftën në ish-Jugosllavi (veçanërisht në Kosovë), planet e mbrojtjes raketore, Iraku, Libia apo dhe Siria.

Për pasojë, ajo që ishte në fillim ishte një fluckë, tanimë u shndërua në një plagë të qelbëzuar. Dhe është pikërisht Evropa, ajo që po vuan më tepër pasojat. Në vend se të drejtonte ndryshimet e një botë të globalizuar, kontinenti i vjetër u kthye në një arenë të trazirave politike, konkurrencës për sferat e influencës, dhe konflikteve ushtarake. Rezultati i pashmangshëm, është se Evropa po dobësohet përditë e më tepër, në një kohë kur qendrat e tjera të pushtetit dhe të ndikimit janë duke u forcuar. Në rast se kjo tendencë vazhdon, Evropa do të humbasë me siguri ndikimin e saj në çështjet botërore dhe gradualisht, do të bëhet e parëndësishme.

Fatmirësisht, përvoja e viteve '80, sugjeron një rrugëdalje. Duhet të rikujtoj, se situata ndërkombëtare në atë kohë, nuk ishte më pak e rrezikshme sesa është sot. Megjithatë, ne patëm sukses në përmirësimin e saj, jo thjesht duke normalizuar marrëdhëniet mes nesh, por duke i dhënë fund vetë Luftës së Ftohtë. Kjo është arritur kryesisht përmes dialogut.

Dhe çelësi i dialogut është vullneti politik dhe vendosja e prioriteteve të drejta. Ndaj sot, prioriteti kryesor duhet të jetë dialogu në vetvete: rinovimi i aftësisë për të bashkëvepruar, për të dëgjuar dhe biseduar me njëri-tjetrin. Disa shenja premtuese deri diku mund të qëmtohen, edhe pse përpjekjet e para kanë dhënë vetëm rezultate modeste dhe të brishta: marrëveshja e Minskut, për një armëpushim dhe mosangazhim ushtarak në Ukrainë; marrëveshja trepalëshe e gazit mes Ruisë, Ukrainës dhe Bashkimi Evropian apo dhe frenimi për të përshkallëzuar më tej sanksionet reciproke.

Ne duhet të vazhdojmë të heqim dorë nga polemikat dhe akuzat e ndërsjella, dhe të kërkojmë pikat e përbashkëta dhe mundësinë e heqjes graduale të sanksioneve, të cilat janë të dëmshme për të dyja palët. Hapi i parë, mendoj se duhet të jetë heqja e të ashtuquajturave “sanksione personale”, që prekin direkt figurat politike dhe parlamentarët.

Kjo do të bënte që këta të fundit t'i ribashkohen negociatave për kërkimin e zgjidhjeve reciprokisht të pranueshme. Një fushë për ndërveprim mund të jetë ndihma ndaj konkrete ndaj Ukrainës, për të kapërcyer pasojat e luftës vëllavrasëse dhe rindërtuar rajonet e prekura nga lufta. E njëjta gjë vlen edhe për sfidat globale dhe sigurisë panevropiane.

Problemet e sotme kryesore, me të cilat përballen bota si terrorizmi e ekstremizmi, varfëria e pabarazia, ndryshimi i klimës, emigracioni dhe epidemitë, janë përkeqësuar çdo ditë e me tepër. Dhe sa të ndryshme janë këto sfida, aq edhe ndajnë së bashku një tipar kyç: askush prej tyre nuk ka një zgjidhje ushtarake. Gjithësesi, fakt është se aktualisht mekanizmat politikë për të zgjidhur këto probleme, po mungojnë ose janë jofunksionale. Vazhdimi i krizës botërore, duhet të na bindë për të kërkuar, pa vonesë, një model të ri, që të mund të sigurojë qën-

drueshmërinë politike, ekonomike dhe mjedisore.

Përsa i përket sigurisë së Evropës, vetëm një zgjidhje panevropiane, është e mundshme.

Në të vërtetë, përpjekjet për të adresuar problemin, duke zgjeruar NATO-n, ose përmes një politike të mbrojtjes së përbashkët të BE-së, janë lëvizje thjesht kundërproduktive. Ne kemi nevojë për institucione dhe mekanizma, që ofrojnë besim dhe garanci për të gjithë.

Mjerisht deri tani, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, tek e cila pati shumë shpresë në fillimet e veta, ka qenë jashtë loje. Kjo nuk do të thotë aspak se OSBE-ja, duhet të zëvendësohet me diçka të re, sidomos tani që ajo ka marrë përsipër funksione të rëndësishme të kontrollit të situatës në Ukrainë. Por unë do të thoja se OSBE-ja, është një ndërtesë që kërkon riparime të mëdha por edhe disa ndërtime e reja.

Vite më parë, ish-ministri i jashtëm gjerman Hans Dietrich Genscher, ish-këshilltari amerikan në Këshillin e Sigurisë Kombëtare, Brent Scowcroft, dhe politikëbërësit e tjerë, propozuan krijimin e një Këshilli Sigurimi, ose një tip Drejtorie për Evropën.

Asokohe, unë e mbështeta nismën e tyre. Thujse në të njëjtën frymë, gjatë presidencës së kryeministrit aktual rus, Dmitri Medvedev, ky i fundit bëri thirrje, për krijimin e një mekanizmi të diplomacisë parandaluese evropiane, me nevojën e konsultimeve të detyrueshme, në rast të një kërcënimi për sigurinë e çdo shteti. Nëse një mekanizëm i tillë, do të ishte ngritur pak vite më parë, ngjarjet tronditëse në Ukrainë mund të ishin shmangur.

Sigurisht, udhëheqësit politikë janë ata që duhet fajësuar për çuarjen në “Kalendarat greke” të kësaj apo ndonjë tjetër “ideje evropiane”. Por përgjergjësia, duhet gjithashtu të ndahet me të gjithë klasën politike evropiane, institucionet e shoqërisë civile dhe median.

Ndonëse nga natyra unë jam optimist, më duhet ta pranoj se është shumë e vështirë të mos jesh pesimist në fund të vitit 2014. Megjithatë, gjykoj se nuk duhet të biem pre e panikut dhe dëshpërimit, apo të lejojmë veten të tërhiqen nga vorbullat e inercisë negative.

Përvoja e hidhur e muajve të fundit, duhet të transformohet në një vullnet për të rifilluar dialogun dhe bashkëpunimin. Ky është apeli im për udhëheqësit tanë e për të gjithë ne, për vitin 2015: Le të mendojmë, propozojmë dhe veprojmë së bashku.

/Copyright Project Syndicate/www.project-syndicate.org



Eurozona duhet të veprojë para se deflacioni ta rrënojë

NGA WOLFGANG MÜNCHAU

Mjerisht, ne kemi përsëritur çdo gabim që Japonia bëri në vitet '90 dhe pastaj i kemi shtuar edhe disa nga gabimet tona. Është vërtet tragjike, që historia ekonomike nuk ka ndikimin e pritur tek hartuesit e politikave evropiane. Kjo është arsyeja e vërtetë, se përse deflacioni është rikthyer

Deflacioni në eurozonë nuk ka të bëjë aspak me çmimin e naftës. Shkaku i tij gjendet realisht në një seri gabimesh të politikës ekonomike përgjatë disa viteve më rradhë, ku mund të përmendim rritjen e normave të interesit në vitin 2011, dështimin për të vepruar në kohë, kur norma e inflacionit ra në mënyrë drastike në vitin 2013, apo edhe marrjen e masave shtrënguese në një periudhë recesioni. Në rast se Banka Qëndrore Evropiane, do të kishte përmbushur objektivin e saj për një inflacion "afro por nën 2 për qind", rënia e çmimit të naftës do të ishte e padëmshme. Inflacioni do të kishte rënë e shumta nga 2 në 1 për qind dhe bankierët qendrorë, do të kishin luksin ta injoronin një dukuri të tillë. Por kur kjo rënie fillon që t'i afrohet zero përqindëshit, ekonomia hyn në deflacion.

Një vit më parë, u tha se eurozona ishte vetëm një hap larg nga deflacioni. Prej

atëhere, ne kemi patur dy ngjarje tronditëse: agresionin e Rusisë ndaj Ukrainës dhe rënien e çmimit të naftës. Tronditjet në ekonomi edhe mund të ndodhin. Rënia e çmimit të naftës së papërpunuar, zakonisht është në të mirë të një importuesi neto naftës, sikurse edhe është eurozona.

Por duhet të kihet mjaft kujdes mbi efektet e raundit të dytë, që zakonisht vijnë me vonesë. Ka që tani shenja të qarta që negociatorët gjermanë të pagesave, në formulat e tyre të pagave, po e ulin nivelin e inflacionit nën që është objektivi zyrtar i BQE-së.

Ata kërkojnë të llogarisin rritjet, duke mbledhur së bashku objektivin e BQE-së për inflacionin prej 2 përqind dhe disa pjesë të rritjes së produktivitetit gjerman. Por, me inflacionin e mbërthyer në nivelin zero, një formulë e tillë lejon vetëm produktivitetin që gjithashtu nuk është rritur dhe aq shumë. Nëse pritshmëritë për inflacionin bien, kështu do të ndodhë edhe me rrijen e pagave.

Elison Mandra nga "Brygel", një think-tank me qendër të Bruksel, llogarit se pagat nominale në Gjermani u rritën me 2.4 për qind në vitin 2014. Fatkeqësisht, kjo është aq e mirë vetëm përse kohë që e merrni. Sinjalet e para në fillim të këtij viti, tregojnë se rritja e pagave po pasohet sërish nga një ulje e tyre.

Kompanitë gjermane po sillen në mënyrë racionale. Inflacioni në zonën euro kohët e fundit u kthye në terma negativë. Vlera negative për dy vite me rradhë e bonove gjermane – zero për 5 vite – dëshmon se investitorët parashikojnë që inflacioni të jetë afër zeros për një kohë shumë të gjatë. Atëherë përse negociatorët e pagave të kompanive, duhet të presin diçka ndryshe?

Inflacioni i ulët çon drejt pagave më të moderuara, që nga ana e tyre bien në rastin e rritjes së inflacionit në të ardhmen. Nga momenti kur çmimi i naftës bie poshtë indeksit të inflacionit për rreth 12 muaj rresht, pagat mesatare në vitin 2015 do të kenë tendencën që të "zvarriten" poshtë normës së inflacionit.

Po çfarë ndikimi do të ketë ky skenar tek politikat ekonomike? Më shumë gjasa, kur krerët e BQE-së të mblidhen në datën 22 janar, do të aprovojë një program të lehtësimit sasior, që me fjalë të tjera do të thotë blerja e borxheve publike të shteteve anëtare të BE-së.

Shpresa ime është që lehtësitë sasiore do të zgjasin pak dhe kjo për një numër arsyesh. Mbi të gjitha, për shkak se shkalla e blerjeve nuk mund të jetë shumë e madhe. Thjesht mund të mos funksionojë aq mirë, sa edhe në një ekonomi me një treg të vogël kapitalesh apo një sistem i ndryshëm i financimit të ndërtimit të shtëpive të banimit në krahasim me SHBA-në apo Britaninë e Madhe, ku lehtësimi sasior ishte efektiv, për shkak se zgjidhi çështjen e mprehtë sociale të strehimit.

Varianti absolutisht më i keq i QE-së, aktualisht në diskutim, është ai ku çdo bankë qendrore kombëtare blen borxhin e qeverive të veta, çka do të shënonte fundin e një politike të vetme monetare. Nëse kjo ndodh, ju do të dëshironit që të mos kishit vendosur kurrë QE-në si mjet parësor veprimi.

Çfarë mbetet tjetër? Mjeti më i skajshëm që politika monetare ka në dispozicion do të jetë skena klasike e një helikopteri që hedh nga lart shuma të mëdha parash, një teori kjo që mbrohet nga ekonomistët Xhon Mjuelbauer dhe Uilliam Buiter. Profesor Mjuelbauer propozon konkretisht një pagesë modeste prej 500 eurosh nga BQE, për çdo qytetar apo banor të eurozonës. Megjithatë unë them se nuk ka asnjë arsye për të mos shkuar në shifra më të larta, nëse ju me të vërtetë kërkonit të krijoni inflacion.

Një pagesë prej 10 mijë eurosh për çdo qytetar do të përkthehet në 3 trilionë euro, shumë që do të ishte e një madhësie të njëjtë me programin e 'lehtësimit sasior' në Britaninë e Madhe.

Një "ulje e tillë" helikopteri mund të funksiononte, por druaj se në mënyrë të trishtueshme dhe për më tepër do të ishte shumë e pazakontë për mendësinë kontinentale evropiane. Një mundësi pak më realiste do të ishte një kombinim i

QE, një stimuli të jashtëm nga nafta dhe një nxitjeje fiskale. Rregullat fiskale në eurozonë, lënë në fakt pak hapësirë për një rritje të jashtëzakonshme të shpenzimeve, ose një ulje në taksat.

Por nga ana tjetër, rregullat fiskale janë mjaftueshëm fleksibël për t'i lejuar vendet që të merren me emergjencat. Pas sulmeve terroriste të javës së shkuar në Paris, do të ishte e përshtatshme dhe e realizueshme si për presidentin francez Fransua Holond, ashtu edhe udhëheqës të tjerë evropianë, që në këto rrethana të jashtëzakonshme të miratojmë progama për nxitje fiskale, e lidhur ngushtësisht me shpenzimet për sigurinë kombëtare, pa kompensuar kursimet apo rritur taksat. Por nëse terrorizmi nuk është arsye e mjaftueshme, çfarë ka tjetër? Hëpërhë, shpresa më e mirë për eurozonën mbetet një program ambicioz QE, një efekt pozitiv mbi konsumin dhe investimet nga çmimi i naftës, si dhe një rritje e shpenzimeve.

Kjo mund të funksionojë. Ndonëse, duke patur parasysh përvojat e mëparshme, me nivelin e koordinimit të politikave dhe mungesën e urgjencës në mesin e politikëbërësve, shanset e suksesit nuk janë shumë të mëdha. Skenari im kryesor, vazhdon të jetë një stanjacion shekullor. Mjerisht, ne kemi përsëritur çdo gabim që Japonia bëri në vitet '90 dhe pastaj i kemi shtuar edhe disa nga gabimet tona. Është vërtet tragjike, që historia ekonomike nuk ka ndikimin e pritur tek hartuesit e politikave evropiane. Kjo është arsyeja e vërtetë, se përse deflacioni është rikthyer. /FT/



Zotërinjtë e Shtëpisë së Bardhë

Nga Kenedi tek Kuomot, nga Bush tek Klintonët: janë dinastitë amerikane, që kanë shkruar historinë e vendit, duke u alternuar në pushtet për breza me radhë. Endrju, po mbante një takim në Bufalo, teksa babai i tij, ndërroi jetë në Nju Jork. Hilari e Xheb, do të përballen me shumë gjasa, në zgjedhjet presidenciale të vitit 2016, në rolin e udhëheqësve të dy partive që dominojnë SHBA: demokratët dhe republikanët

Guvernatori i Nju Jorkut, Endrju Kuomo, mbajti dje në Bufalo, gjatë një ceremonie me rastin e fillimit të mandatit të dytë në këtë post, një fjalim me një retorikë mjet emfatike, që trajtonte çëshjet më kryesore me të cilat përballtet shteti dhe mbarë vendi: nga kriza e drejtësisë, pabarazia sociale dhe deri tek mbrojtja e klasës së mesme.

Vëzhguesit që analizuan tekstin, ishin në një mendje, se ai fjalim ishte një tjetër hap para, në drejtim të një kandidimi të mundshëm të tij për president. Një synim ky, që ka përshkuar prej 23 vitesh karrierën politike të Kuomos. Në të njëjtën kohë në anën tjetër të shtetit, i rrethuar nga dashuria e familjarëve në banesën e tij në Manhatan, babai Mario po jepte frymën e fundit, ndërsa vdekja në fakt ndodhi pak orë më vonë, pas një tjetër goditje që pësoi zemra e luftëtarit veteran. Mario, djali i dy emigrantëve italianë nga Noçera e Salernos, kishte qenë guvernator i Nju Jorkut nga viti 1983 deri në vitin 1994. Për një dekadë, ai mbajti në ankth vendin dhe Partinë Demokratike me pritshmërinë, asnjëherë të realizuar të kandidimit për postin e presidentit. Tashmë familja Kuomo, është një dinasti politike e dorës së parë në skenën amerikane.

Zgjedhja

Një ditë para vdekjes së Mario Kuomos, në Majami ish-guvernatori i Floridës,

Xheb Bush dha dorëheqjen nga të gjitha postet zyrtare e private që ai mbante. Edhe ky i fundit, pas dy dekadave joshjeje nga ana e Partisë Republikane, është tanimë gati të zbresë në fushëbetejë, për të garuar në të njëjtën zonë elektorale, që konfirmoi fitues fillimisht të atin Xhorxh H. W. Bush në vitin 1980, dhe më pas vëllain e tij Xhorxh W. Bush, 20 vjet më vonë.

Familja Bush është prej kohësh një dinasti politike e padiskutueshme në arenën publike amerikane. Fakt është se familjariteti dhe demokracia, shkojnë shumë mirë krah njëra-tjetrës në politikën amerikane. Në njëërën anë janë trashëgimtarët e ëndrrës populiste, që lejon gjithkënd të fitojë, me armët e vetme të ambicjes dhe sakrificës.

Barak Obama, është një njeri i lindur nga një studente me prejardhje modeste, dhe që u rrit pa e njohur babain e saj. Përpara tij, demokratët patën sjellë në pushtet, Bill Klintonin, djalin e një shitësi ambulant të akloolizuar, që vdiq 3 muaj pas lindjes së të birit.

Por përkrah këtyre figurave që u “vetëndërtuan”, ndodhen shpesh një zhgan politikanësh që ndjekin njëri-tjetrin, brez pas brezi, në një sistem aristokracie të padeklaruar zyrtarisht, por që megjithatë është faktike. Nëse Klinton, ishte një kampion i ngjijtes së shpejtë në majë, duke filluar nga shkallët më të ulëta, zëvendësi i tij Al Gor, vinte nga një familje e pasur naftëtarësh, që militonte në politikë prej të paktën 70 vjetësh dhe që e lidhur përmes martesash, me gjakun blu të disa dinastive që dominojnë skenën kombëtare. Nepotizmi është në fakt një akuzë që mund t’i bëhet shumëkujt në SHBA, duke filluar që prej etërve të pavarësisë së vendit. Njëri nga nipërit e Xhorxh Uashingtonit u bë gjykatës në Gjykatën e Lartë. Një kushëri i presidentit të dytë amerikan, Xhon Adams, ishte mes atyre që firmosën Deklaratën e Pavarësisë. Ndërsa djali i tij Xhon Kuinsi Adams, u zgjodh presidenti i gjashtë i SHBA-së. Ndërkohë, lindja e dinastive, është e lidhur me afirmimin e fuqisë industriale të SHBA, dhe shfaqjen e “baronëve” në fillim të viteve ‘900.

Mes tyre, familja më e njohur në Nju Jork ishte ajo e Rokfelerit, e destinuar të qeveriste qytetin, shtetin dhe zv.presidentencën e SHBA, deri vitin e kaluar, që shënoi edhe bratisjen e skenës politike nga ana e pinjollit të fundit të familjes, senatorit të shtetit të Delauerit, Xhej Rokfeler.

Për një kohë të gjatë, dominimi i këtyre familjeve, ka patur një karakter rajonal. Psh. Kenedit “mbretëronin” në Nju Inglënd, duke filluar më së pari nga Massachusettsi, ku ende sot është pjesë e parlamentit lokal, Xho Kedi III, stërnipi i ish-presidentit Xhon Kenedi.

Ndërkaq Harisonët, që u detyruan të heqin dorë nga titulli fisnik britanik i baronëve të Lankashajërit, ia dolën gjithësesi të ruajnë kontrollin politik të Virxhinias, prej ku u zgjodhën dy presidentë, si dhe një numër i madh guvernatorësh. Ruzveltët nga ana tjetër, ishin të rrënjosur në Nju Jork, Muhlenbergët në Pensilvani dhe familja Taft në Ohajo.

Vetëm kohët e fundit, lëvizshmëria gjeografike dhe sociale, ka pështjelluar disi këtë konfigurim dhe vetë familja Bush, është një shembull domethënës.

Ngjitja e kësaj familjeje, filloi me fabrikat e gomës në Ohajo, vazhdoi më pas me sektorin bankar në Konektikat e së fundmi u mbështet nga industria teksane e naftës. Në rrugën drejt garës së ardhshme presidenciale në vitin 2016, pinjollit i familjes Bush, Xhebi do të gjejë me shumë gjasa përballë Hilari Klintonin, një tjetër përfaqësuese e një pushteti që duke sikur përjetësohet, sapo merret ne duar.

Bashkëshorti i saj Bill, ia doli për të parën herë, të shndërronte trashëgiminë politike, të fituar gjatë presidencës së tij në Uashington, në një trashëgimi financiare të pashtershme, me të cilën me shumë mundësi, do të mbështesë gruan e tij në fushatën paraprake zgjedhore në vetë gjirin e PD. Ndoshta, do të nxisë në një të ardhme jo shumë të largët, edhe ambicjet politike që tani të dukshme të së bijës, Çelsi. /messaggero/



Europa në 2015: Një vit pasigurie

Në intervista në rrugë shumë të rinj e shohin veten si “brezi i pasigurtë”. Me qëllim që Europa të rigjejë stabilitetin dhe rikthejë besimin në projektin europian, atëherë duhet të merremi me pasiguritë e brezit të ri. Herman Van Rompuy, presidenti i parafundit i Këshillit Europian, e përmbloodhi shumë mirë atë që është në lojë: “Pa Mbretërinë e Bashkuar, Europa do të ishte e lënduar, madje e sakatuar – kështu që duhet bërë gjithçka për të shmangur që kjo të ndodhë. Por do të mbijetojë. Pa Francën, Europa – ideja europiane – do të ishte e vdekur”

Për Europën, 2015 do të jetë një tjetër përpjekje për të arritur në një vend të sigurtë. Gjatë dy viteve të fundit, zyrtarë dhe udhëheqës europianë kanë shpallur se kriza ekonomike ka marrë fund. Por në gjashtë muajt e fundit, është rikthyer një lloj parandjenje jo e mirë.

Rreziqet nuk janë të njëjtë si në 2012-ën. Nuk ka rrezik shtetesh që nuk janë në gjendje të financojnë borxhin e tyre. Tani, rreziku vjetn prej stanjacionit dhe deflacionit.

Zyrtarët europianë kanë paralajmëruar herë pas here se dështimi në krijimin e rritjes ekonomike dhe vendeve të reja të punës rrezikon jo vetëm tensione sociale, por edhe mbështetje për projektin europian. Gjasat janë që ekonomia e Europës

nuk do i arrijë nivelet e 2007-s para vitit 2020.

Në vitin 2015, rimëkëmbja ekonomike do të jetë e pabarabartë. Kërkesa është e dobët. Gjermania do të mbetet motorri i ekonomisë europiane, por gjithësesi nuk do të jetë “centrali” që ishte dy vjet më parë. Rritja ekonomike në Francë do të jetë rreth 0.7%. Italia do i largohet recesionit, por eurozona nuk pritet të ketë një rritje ekonomike më të lartë se 1% dhe kjo nuk do të mjaftojë për të zbutur një normë papunësie që mbetet në 11.7%.

Edhe një herë sytë janë kthyer nga Presidenti i Bankës Qendrore Europiane, Mario Draghi. Pritet që në tremujorin e parë të vitit ai të hapë rubinetat, të forcojë kërkesën dhe të blejë bono sovraane. Por, mund të mos jetë e lehtë. Ka kundërshtime të fortë në Gjermani; mund të ketë edhe sfida ligjore ndërkohë që ka dyshime për impaktin që mund të ketë kjo lëvizje.

Kundër masave të kursimit

Europa duket se vazhdon të mbështesë “bastin” e saj në mbajtjen ulët të vlerës së Euros si dhe eksportet më të lirë, për të rritur kërkesën brenda saj. Pakënaqësia popullore me programin e kursimit po rritet. Edhe një herë ka gjasa të ketë tensione mes Berlinit, që vazhdon të kërkojë reduktim të deficiteve nën 3% si dhe që të reformohen ligjet e punësimit, si dhe Parisit dhe Romës, të cilët besojnë se Europa ka nevojë për rritje ekonomike dhe investime në projekte të mëdhenj infrastrukturorë.

2015 do u japë edhe një herë partive që janë kundër establishmentit shansin për të shfrytëzuar pakënaqësinë në Europë. Ka zgjedhje ku këto parti mund të luajnë role kyçë. Brenda pak javësh, Greqia mund të votojë për partinë radikale të krahut të majtë, Syriza, që aktualisht kryeson në sondazhe. Nëse fiton, kjo parti do të kërkojë ristrukturim të borxhit si dhe do të rrisë frikën për një rikthim të krizës greke.

Më vonë gjatë vitit, në sondazhe do të shkojnë spanjollët. Edhe aty ka një parti radikale të majtë me emrin Podemos, e cila është pozicionuar fort kundër masave të shtrëngimit. Dhe në Britani, në maj, Partia për Pavarësi e Mbretërisë së Bashkuar mund të ketë një rol të rëndësishëm në negociatat për ndarjen e pushtetit pas zgjedhjeve.

Një prej faktorëve kryesorë që redukton mbështetjen për partitë kryesore është papunësia. Në Francë, numri i atyre që kërkojnë punë ka arritur nivele rekord. Në nëntor, shifra e papunësisë u rrit me 27400, duke arritur në 3 488 300. Numri i atyre që kërkojnë punë është rritur me 5.8% vitin që kaloi. Kjo gjë rrezikon të ardhmen politike të presidentit Hollande. Nëse administrata e tij nuk fillon të krijojë vende pune në 2015-ën, ai do të jetë një president “i çalë” dhe kjo shkon në favor të Frontit Nacional të Marine Le Penit.

2015-a do të testojë gjithashtu nëse ish presidenti i Francës, Nicolas Sarkozy, jo vetëm do të ketë një kontroll të fortë të partisë së tij, por edhe nëse populli francez do t’i japë një shans të dytë.

Në Itali, Matteo Renzi po përballlet me kundërshtime ndaj reformave të tij, por testi i vërtetë do të jetë nëse ato reforma do të zbuten dhe nëse do të zbatohen në mënyrë rigorozë. Gjendja në Itali është e brishtë; një vend që ka parë shumë pak rritje ekonomike në dhjetë vitet e fundit. Dy prej partive të opozitës në vend janë haptas kundër BE-së, ndërkohë që njëra kërkon të hidhet në votim qëndrimi në euro.

Imigrimi

Asnjë çështje nuk e pasqyron më mirë luhatshmërinë e humorit në Europë, se sa migrimi dhe imigrimi. Edhe një herë, gjatë muajve të verës do të kemi numra të mëdhenj njerëzish që largohen prej paqëndrueshmërisë në Lindjen e Mesme dhe Afrikë, në përpykje për të kaluar Mesdheun dhe mbërritur në Europë.

Politikanët e partive kryesore do të mundohen shumë me këtë sfidë. Gjermania, që ka pranuar shumë më tepër refugjatë nga Lindja e Mesme se sa çdo vend tjetër,

kohët e fundit është trënditur prej protestave. Pak përpara Krishtlindjeve, 17500 vetë marshuan në Dresden me banderolën: “Europeanët patriotë kundër islamizimit të Perëndimit”. Pati protesta edhe në qytete të tjerë. Establishmenti politik gjerman është trënditur prej këtyre protestave në rrugë dhe udhëheqësit politikë kanë bërë thirrje për “mirëkuptim dhe hapje”.

Kjo demonstroi se shqetësimi për migrimin nuk është i kufizuar në Britani. Në shumë vende europiane, kjo është një çështje politike shumë e fortë, e cila po kontribuon në ngjytjen e partive që janë kundër establishmentit. Udhëheqësve të Europës u duhet të gjejnë një përgjigje bindëse.

Europa do të presë me një farë ankthi që të zbulojë rezultatin e zgjedhjeve në Britani. Një zyrtar i lartë europian tha se Mbretëria e Bashkuar – pas ekonomisë së BE – do të jetë tema qendrore europiane gjatë tre viteve të ardhshëm.

Nëse David Cameroni mbetet në detyrë, pritet që në gjysmën e dytë të vitit të fillojnë diskutimet se si do të jetë lista e tij e rinegociimeve – përpara një referendumit për të qëndruar ose jo në BE, i cili do të mbahet në 2017-ën. Në samitin e Këshillit Europian në qershor pritet që ai të parashtojë në vija të përgjithshme se çfarë kërkon. Ai do të përballet edhe me një dëshirë për ta mbajtur Britaninë në BE, por dhe një mungesë gatishmërie për të ofruar lëshime që do ta bënin Mbretërinë e Bashkuar një rast special, apo që do të dëmtonin parimet themelore të BE-së, si për lëvizja e lirë.

Mbetet e paqartë se cili do të jetë procesi për këto negociata. Disa udhëheqës europianë janë shpresëplotë se ndryshimet mund të vijnë përmes legjislacionit dytësor, por në fund gjasat janë që një rinegociim për Britaninë mund të kërkojë ndryshim të traktatit.

Disa vende, si Gjermania, besojnë se traktatet do të duhet të ndryshojnë për të mbështetur arkitekturën e re të eurozonës. Ata besojnë se BE është tashmë në skajet e asaj që lejojnë traktatet. Por ka shumë pak dëshirë për të thirrur një konferencë ndërqeveritare dhe Franca do të ishte kundër çdo lloj hapi që çon në një referendum.

Kështu që, për Britaninë rruga drejt rinegociimit do të jetë e gjatë dhe e vështirë si dhe do të jetë një test madhor për diplomacinë britanike, e cila kohët e fundit nuk e ka lexuar gjithmonë saktësisht humorin e Europës.

Në vitin 2015, Komisioni Europian do të duhet të demonstrojë se ka vullnetin dhe fleksibilitetin për të realizuar reforma domethënëse. A do të vihet në lëvizje fondi i tij 300 miliardësh i investimeve? A do të ndërmerret BE hapa konkretë drejt një tregu të përbashkët digjital apo një unioni energjetik?

Presidenti i Komisionit, Jean-Claude Juncker është shfaqur plot vetëbesim. Ai është një takticien i zhdërvjellët, që udhëheq një Komision pragmatist. Megjithatë, mbetet i goditshëm sa i përket kohës së tij si kryeministër i Luksemburgut, kur kompanitë vendoseshin në këtë dukat të vogël për t'i shpëtuar taksimit gjatë. Duhet që të mbijetojë, për arsye se dy partitë më të mëdha në Parlamentin Europian e mbështesin. Megjithatë, Junckeri do të jetë në rrezik nëse do të rezultojë të ketë qenë një kryeministër aktivist, që inkurajonte kompanitë të rroknin skema që i ndihmonin të shmangnin taksat.

Ylli i Komisionit të ri duket se do të jetë Frans Timmermans, zëvendës-presidenti i parë. Ai është shfaqur tashmë si një avokat i zoti i BE-së në disa gjuhë dhe me siguri do të luajë një rol kyç në një referendum të ardhshëm në Mbretërinë e Bashkuar.

Testi i Ruisë

Rusia do të mbetet një e panjohur trazuese. Një llogaritje e gabuar në Ukrainën Lindore mund ta zhysë Europën në një tjetër Luftë të Ftohtë. Ekonomia e Ruisë është në telashe. Kohët e fundit, ish ministri i Financave, Alexei Kudrin ka deklaruar: “Ne kemi hyrë ose jemi duke hyrë në një krizë të plotë ekonomike”.

Kjo gjë do ta dëmtojë më tej ekonominë europiane. Në 2015, uniteti europian me

gjasë do të testohet sërish në çështjen e Rusisë. Disa vende – si Franca dhe Italia – mund të tundohen të kërkojnë një lehtësim të sanksioneve. Rusia e ka potencia-
lin që të shndërrohet në lajmin dominues të Europës për vitin 2015.

Në intervista në rrugë shumë të rinj e shohin veten si “brezi i pasigurtë”. Me qëllim që Europa të rigjejë stabilitetin dhe rikthejë besimin në projektin europi-
an, atëherë duhet të merremi me pasiguritë e brezit të ri. Herman Van Rompuy,
presidenti i parafundit i Këshillit Europian, e përmbodhi shumë mirë atë që
është në lojë: “Pa Mbretërinë e Bashkuar, Europa do të ishte e lënduar, madje e
sakatuar – kështu që duhet bërë gjithçka për të shmangur që kjo të ndodhë. Por
do të mbijetojë. Pa Francën, Europa – ideja europiane – do të ishte e vdekur”.
Edhe një herë, në 2015-ën Europa do të përballet me pikëpyetje të mëdha mbi të
ardhmen e saj. /BBC/



DOSSIER / Sekret i Asadit

NGA ERIK FOLAT
DER SPIEGEL

Për vite të tërë, mendohej se Izraeli ia kishte dalë të shkatërronte aftësinë e prodhimit të armëve bërthamore nga Siria, me sulmet ajrore të vitit 2007 në kompleksin e Kibarit. Por ja që nuk është kështu. Hetimet më të fundit sugjerojnë se Bashar al-Assad është ende duke u përpjekur për të ndërtuar bombën bërthamore, dhe se ai mund të jetë duke marrë ndihmë nga

Në orën 11 të mbrëmjes, në 5 shtator të vitit 2007, 10 avionë bombardues luftarakë F-15 u ngritën në ajër nga baza ushtarake izraelite “Ramat David”, në jug të qytetit të Haifas. Skuadrilja u drejtua për në Detin Mesdhe, zyrtarisht për një mision trajnimi. Gjysmë ore më vonë, 3 nga aeroplanët u urdhëruan që të kthehen në bazë, ndërsa të tjerët ndryshuan kurs, duke fluturuar mbi Turqi drejt kufirit sirian.

Atje, ata eliminuan një stacion radarësh me sinjale elektronike dhe pas më shumë se 18 minutash, arritën në qytetin e Deir El-Zor, që ndodhet në brigjet e lumit Eufrat. Objektivi i tyre ishte një kompleks strukturash i njohur si “Kibar”, në lindje të qytetit sirian. Izraelitët hapën zjarr, duke përdorur raketat “Maverick” dhe bombat 500 kilogramëshe dhe për pasojë shkatërruan tërësisht fabrikën. Pilotët u rikthyen në bazë pa asnjë dëmtim dhe operacioni “Orchard” (Drufruto-

ri) kishte sjellë rezultate mjaft të mira. Në Jeruzalem, kryeministri Ehud Olmert dhe këshilltarët e tij më të ngushtë ishin të ngazëllyer, në bindjen se presidenti sirian Bashar Al-Assad po përpqej të ndërtonte një armë bërthamore dhe se në Kibar thuajse kishte përfunduar ndërtimi i instalimeve të reaktorit.

Izraelitët besonin se operacioni i tyre i rrezikshëm kishte shpëtuar botën nga një rrezik i madh.

Por ata gjithashtu deshën të parandalonin përshkallëzimin e situatës dhe kjo ishte arsyeja se përse nuk kishin informuar as SHBA-të për planin e tyre të bombardimeve. Kryeministri Olmert i telefonoi Uashingtonit, vetëm pasi operacioni kishte përfunduar.

“Drufrutori”, gjithashtu duhet të mbetet sekret edhe për publikun e gjerë në Izrael, në mënyrë që të shmangej çdo lloj shfaqjeje triumfalizmi. Ata nuk deshën që të bëhet e ditur, se ekspertët bërthamorë të Koresë së Veriut ishin angazhuar në Deir el-zor, duke ndihmuar në ndërtimin e reaktorit. Izraelitët, shpresonin të siguronin një alibi, për të hedhur poshtë akuzat e Asadit mbi incidentin dhe për pasojë të shmangin sulmet hakmarrëse.

Dhe akuzat në fakt erdhën. Asadi, u ankua për shkeljen e hapësirës ajrore siriane dhe bombardimin e një “depoje”, por versioni zyrtar pretendonte se forcat ajrore siriane kishin arritur që të përzinin agresorët. Publiku i gjerë në atë kohë nuk e mësoi dot atë që kishte ndodhur në realitet.

Tashmë, informacione sekrete të sigurara nga “Der Spiegel”, dëshmojnë se bota sërish është duke u mashtruar nga Asadi. Diktatori i Sirisë nuk ka hequr dorë nga ëndrra e tij për të patur armën bërthamore, dhe mesa duket në një vend të fshehtë e ka ndërtuar një instalim të ri bërthamor. Kjo është edhe pjesa jashtëzakonisht shqetësuese e lajmit.

Grimcat e dyshimta të uranimit

Nëse kthehemi pas në vitin 2007, ngjante e pamundur të shuajë krejtësisht thashethemet në lidhje me kompleksin misterioz, të ndërtuar në shkretëtirë dhe qëllimin e tij të mundshëm ushtarak. Në dallim nga Izraeli dhe Pakistani, Siria është nënshkruese e Traktatit për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore, dhe është për pasojë e detyruar të përdorë energjinë bërthamore vetëm për qëllime paqësore. Agjensia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike në Vjenë ka kërkuar të inspektojë nga afër stabilimentin. Në qershor të vitit 2008, Asadi më në fund iu dorëzua presionit të IAEA-së, dhe ekspertët nën drejtimin e finlandezit Olli Heinonen, u lejuan të inspektojnë objektin e shkatërruar në Kibar.

Shumë shpejt u bë e qartë se Damasku, kishte bërë gjithçka që mundej, për të shkatërruar të gjitha gjurmët e asaj që kishte qenë ndodhur atje. Por inektorët e agjensisë ishin megjithatë në gjendje të gjenin grimca të dyshimta të uranimit, një zbulim që qeveria siriane u përpoq ta “shiste” si një akt të mundshëm sabotazhi. Edhe pse agjensia u shpreh se hetimi i saj nuk arriti që të gjejë prova përfundimtare, për shkak të dyshimeve të vazhdueshme, u kërkua qasje edhe në 3 objekte të tjera. Agjensia pra dyshonte se këto 3 objekte mund të kishin lidhje të drejtpërdrejtë me Kibarin. Dyshimet binin në veçanti tek stabilimenti i pasurimit të uranimit në Marj as-Sultan, që ndodhet 15 kilometra në veri të Damaskut. Sirianët refuzuan, të zemëruar nga ato që ata i quajtën “shpifje të pabaza.”

Imazhe të qarta të operacionit izraelit dhe detajet e sulmit komando u bënë të mundura vetëm nga një rindërtim i saktë i ngjarjes nga “Der Spiegel” në vitin 2009, që u pasua nga një mori intervistash me udhëheqës politikë, ekspertë bërthamorë dhe ekspertë të shërbimeve sekrete. Sigurisht, gjatë intervistës dhënë për revistën gjermane, presidenti sirian mohoi të kishte ambicie për ndërtimin e bombës bërthamore. “Ne duam një Lindje të Mesme pa armë bërthamore, përfshi këtu edhe Izraelin” – tha ai.

Por një raport investigativ i Agjensisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në maj të vitit 2011, dhe një artikull i “New Yorker” në 2012-ën, e bëri të qartë edhe

për më skeptikët, se Siria ishte duke luajtur me zjarrin. “Agjensia konstaton se ndërtesa e shkatërruar, me shumë gjasa ka qenë një reaktor bërthamor” – vinte në dukje, me një qartësi të pazakontë, raporti i IAEA.

Më pas, i gjithë aktiviteti ndaloi në instalimet e shkatërruara, sikurse tregohet nga imazhet satelitore të zonës, të analizuar rregullisht. Por a do të thotë kjo se sulmi izraelit i dha me të vërtetë fund të gjitha planeve siriane për zhvillimin e një bombe bërthamore?

Kërkimi i vazhdueshëm për bombën

Dukej se fabrika kishte qenë në prag të përfundimit të saj dhe shumë vëzhgues besonin në atë kohë se mund të ishte një depo e fshehtë karburanti, e mjaftueshme së paku për një vit aktivitet. Sipas hetimeve nga agjensia bërthamore, Siria zotëron deri në 50 tonë uranium natyral, material ky i mjaftueshëm për prodhimin e 3 deri në 5 bombave, pasi procedura e pasurimit të ketë përfunduar.

Instituti për Shkencë dhe Siguri Ndërkombëtare në Uashington, gjithashtu ka sinjale të forta për ekzistencën e stoqeve të tilla, ndërsa e shprehu shqetësimin publikisht në shtator të vitit 2013.

“Kjo magazinë e madhe e metalit të uraniumit natyror paraqet rreziqe serioze të përhapjes bërthamore” – nënvizoi instituti në raportin e tij.

“Uraniumi mund të bjerë në dorë të organizatave të tilla si Hezbollah apo Al-Kaeda, ose nga shtete që kanë programe të padeklaruar bërthamore, sikurse është Irani”. Megjithatë, sipas gjetjeve të agjensive perëndimore të inteligjencës, situata është shumë më shpërthyes nga sa mendohej më parë. Bazuar në dokumentet që zotëron “Der Spiegel”, agjensitë janë të bindura se Asadi është duke vazhduar përpjekjet e tij për të ndërtuar bombën.

Analistët, thonë se programi sirian për ndërtimin e armës bërthamore, ka vazhduar në fshehtësi në një bazë nëntokësore. Sipas informacioneve që ata kanë marrë, rreth 8000 shufrat e lëndës djegëse janë ruajtur në atë bazë. Për më tepër, një reaktor i ri ose një stabiliment i pasurimit të uraniumit, me shumë mundësi është ndërtuar në atë vend, një zhvillim ky me pasoja të pallogaritshme gjeopolitike. Mesa duket, një sasi e uraniumit ishte e fshehur për një periudhë të gjatë në Marj As-Sultan afër Damaskut, një vend që agjensia e sheh gjithashtu me dyshim. Imazhet satelitore nga dhjetori 2012 deri në shkurt 2013, dëshmojnë qartë aktivitetin e dyshimtë në Marj As-Sultan.

Objekti, që ndodhet jo shumë larg nga një bazë e ushtrisë siriane ishte shndërruar në epiqendrën e luftimeve të ashpra me rebelët. Trupat qeveritare, u detyruan me shpejtësi të zhvendosnin prej andej çdo gjë me vlerë. Nga rindërtimi i ngjarjes që kanë bërë shërbimet sekrete, ushtria siriane e kreu këtë zhvendosje me ndihmën e Hezbollahut, krahu radikal shiit i “Partisë së Perëndisë” në Liban. Milicia e mirëarmatosur që financohet kryesisht nga Irani është duke luftuar përkrah trupave të Asadit.

Bisedat e përgjuara

Gjetjet e agjensive të inteligjencës tregojnë se materiali u zhvendos në një vend të fshehur mire nëntokë, në perëndim të qytetit të Kusajrit, më pak se 2 kilometra nga kufiri me Libanin. Ata ia dolën ta lëviznin tamam në kohë, pasi Marj as-Sultan vetëm pak ditë më pas ra në duart e rebelëve, megjithëse në pak kohë u rimorr sërish dhe gjendet ende nën kontrollin e trupave qeveritare.

Prej asaj kohe, ekspertët po mbajnë nën vëzhgim ambjentet e jashtme të Kusajrit, një bazë që dikur e kishin injoruar, me bindjen se kjo e fundit ishte një depo e armëve konvencionale të Hezbollahut.

Analistët krahasuan imazhet e mëhershme satelitore dhe me kujdes shqyrtuan edhe ndryshimet më të vogla. Shumë shpejt, për ta u bë e qartë se ishin para një zbulimi jashtëzakonisht shqetësues.

Sipas analizave të agjensive të inteligjencës, ndërtimi i objektit filloi përsëri në vitin 2009.

Hetimet zbuluan se puna u maskua që në fillim nëpërmjet gërmimit të rërës që hidhej në vende të ndryshme, mesa duket për ta bërë më të vështirë për vëzhguesit nga lart, për të kuptuar sesa i thellë ishte gërmimi.

Për më tepër, hyrjet në objekt ruheshin nga ushtria, çka rezultoi të ishte një masë paraprake e nevojshme. Në pranverën e vitit 2013, në rajonin përreth Kusajrit pati luftime të ashpra. Por përkundër humbjeve të rënda, të pësuar nga njësitë elitë të Hezbollahut që ishin stacionuar atje, zona përreth projektit në minierë u ruajt e paprekur.

Imazhet më të fundit satelitore tregojnë 6 struktura: një ndërtesë rojesh dhe 5 hangarë, 3 prej të cilëve fshehin hyrjet e objektit të nëndheshëm. Ndërkohë stabiliteti ka një lidhje të veçantë me rrjetin e energjisë dhe që e merr nga qyteti i afërt i Blosahut. Një detaj veçanërisht i dyshimtë është pusi i thellë që lidh objektin me liqenin e Zaitas, 4 kilometra larg. Një lidhje e tillë është e panevojshme për një sasi armësh konvencionale, por ajo është e domosdoshme për një reaktor bërthamor.

Prova më e qartë se ajo është një strukturë bërthamore, vjen nga komunikimet me radiomarrëse, të përgjuara kohët e fundit nga një rrjet spiunësh. Në një prej përgjimeve, një zë i identifikuar si një funksionar i lartë i Hezbollahut, dëgjohet duke iu referuar “fabrikës atomike” dhe përmendur Kusajrin. Aty duket qartësisht, se njeriu i Hezbollahut e njeh shumë mirë objektin. Dhe ai zhvillon shpesh telefonata të përditshme me një person veçanërisht të rëndësishëm: Ibrahim Otmanin, kreun e Komisionit të Energjisë Atomike Siriane. Funksionari i Hezbollahut, përdor kryesisht një emër të koduar kur i referohet objektit: “Zamzam”, kuptimi i së cilës është thajse i njohur nga çdo mysliman.

Sipas traditës, Zamzam-i është Pusi i Zotit, i krijuar në shkretëtirë për gruan e Abrahamit, Agarin dhe djalin e tyre Ismail. Pusi mund të gjendet edhe në Mekë, dhe është një nga vendet më të vizituara nga pelegrinët gjatë haxhit. Ata që nuk kanë frikë Zamzam-in, nuk konsiderohen të jenë myslimanë të vërtetë.

Ekspertë koreano-veriorë në Siri ?

Në bisedat e përgjuara, përmendet edhe puna e kryer në objekt nga anëtarët e Gardës Revolucionare të Iranit. Garda është një organizatë paraushtarake, nën kontrollin e drejtpërdrejtë të liderit suprem të Iranit, Ali Khamenei. Ajo kontrollon një pjesë të madhe të ekonomisë iraniane dhe gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në vetë aktivitetin bërthamor të Iranit. Jo të gjithë misionet e saj jashtë vendit janë të konsultuara me qeverinë e presidentit të moderuar Hasan Rohani. Garda Revolucionare është një shtet brenda shtetit.

Ekspertët janë gjithashtu të bindur se Koreja e Veriut është e përfshirë në aktivitetin e Zamzam-it. Tashmë dihet se gjatë ndërtimit të objektit në Kibar, Ibrahim Otmani ka bashkëpunuar ngushtë me Chou Ji Bu, një inxhinier që ka ndërtuar reaktorin bërthamor në Jongbjon në Korenë e Veriut.

Për një kohë të gjatë u mendua se Chou ishte zhdukur. Disa besonin se ai kishte rënë viktimë e një spastrimi politik në Kore. Megjithatë, tani ekspertët perëndimorë të zbulimit, besojnë se ai kaloi në ilegalitet në Damask. Sipas kësaj teorie, Otmani nuk i ka humbur asnjëherë kontaktet me të njohurin e tij “hije”. Ekspertë besojnë gjithashtu se objekti i ri bërthamor nuk do të mund të ishte ndërtuar dot kurrë, pa ndihmën teorike dhe praktike të Koresë së Veriut.

Mjeshtëria që shfaqet tek ndërtimi i shufrave të lëndës djegëse rrit dyshimet për përfshirjen e Koresë së Veriut. Po çfarë masash do të merren tani për Zamzam-in? Si do reagojë Perëndimi, Asadi apo fqinjët e Sirisë ndaj këtij zbulimi? Zbulimi i objektit të supozuar bërthamor, nuk ka të ngjarë të jetë i mirëpritur nga ndonjë prej aktorëve politikë. Ky është një turp për të gjithë. Edhe për Sirinë dhe Korenë e Veriut, që kanë tentuar në mënyrë periodike të shpërfaqin imazhet e tyre si “të dëbuarit” prej ndërkombëtarëve. I tillë është edhe për Hezbollahun, që shpreson të dalë si forca politike kryesore në Liban.

Një vlerësim i ri

Por ky zhvillimi i ri vjen ndërkaq në një kohë të papërshtashme për qeverinë e SHBA-së. Përkundër të gjitha mohimeve zyrtare, Uashingtoni aktualisht po vepron në terren, ku më shumë e ku më pak në bashkëpunim me Asadin, në luftë kundër luftëtarëve islamikë të Shtetit Islamik. Për më tepër, pas shkatërrimit të mirëmonitoruar dhe kryesisht të efektshëm të armëve kimike siriane, SHBA, Britania dhe Franca besuan se aftësia e Asadit për të zhvilluar luftëra jo konvencionale ishte eliminuar. Zhvillimi i mundshëm i një arme atomike siriane, që mbetet të konfirmohet plotësisht, do të çojë në një vlerësim të ri të situatës.

Zbulimi ndërkohë paraqet një dilemë veçanërisht të vështirë për Izraelin. Për të garantuar sigurinë e vet, vendi ka vazhduar të bombardojë linjat e furnizimit të Hezbollahut. Por mesa duket, Tel-Avivi nuk dinte asgjë për një strukturë të mundshme bërthamore. Liderët izraelitë do të ballafaqohen me vendimin e tejet të vështirë, mes injorimit të Zamzam-it ose ndërmarrjes së një sulmi jashtëzakonisht të rrezikshëm, kundër një objekti të ndërtuar thellë nëntokë.

Në kontrast me vitin 2007, në një operacion të tillë do të jenë të nevojshme bombat “buster” antibunker, por që kanë pasoja të paparashikueshme për mjedisin. Do të ishte një vendim i papërgjegjshëm, por gjithësesi një akt që në analizë të fundit, do të ndërmerret nga liderët izraelitë e linjës së ashpër.

Gjithashtu edhe vëzhguesit ndërkombëtarë në Vjenë nuk ndihen të qetë, pasi shefi i agjensisë, Jukija Amano, zbuloi se është mashtruar nga Asadi. Në shtator të vitit 2014, përfaqësuesi japonez kërkoi nga Siria “të bashkëpunojë plotësisht me agjencinë, në lidhje me të gjitha çështjet e pazgjidhura”. Ai nuk ka marrë ende një përgjigje. Sanksioni më ekstrem që mund të ndërmerret në këtë rast, do të ishte përjashtimi i Sirisë nga Agjencia Bërthamore, një skenar ky që ka pak gjasa të vihet në jetë, duket patur parasysht se Moska vazhdon ta mbrojë Asadin, si në IAEA, ashtu edhe në Kombet e Bashkuara.

Shteti Islamik, ftoi kohët e fundit inspektorët e agjensisë bërthamore të hetojnë në zonat nën kontrollin e tyre. Organizata terroriste pushtoi zonën rreth Deir El-Zor disa muaj më parë, dhe i ofroi agjensisë, mundësinë për të vëzhguar përreth objektit në Kibar. Por organizata me qendër në Vienë e refuzoi ftesën, pasi nuk dëshironte t'i siguronte Shtetit Islamik asnjë lloj legjitimiteti. Për më tepër që Deir El-Zor nuk është “thembra e Akilit”. Ekspertët ndërkombëtarë në Vjenë, tani gjejnë veten në përballje me sfidat e reja në të gjithë vendin kufitar me Libanin. / Marrë nga “Der Spiegel International” /